



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.11.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.10.2020.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për prokurimin publik”.

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Fatmir Velaj, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Taulant Balla, Klodiana Spahiu, Mirela Kumbaro, Ralf Gjoni, Nikolin Staka, Kostaq Papa, Edlira Hyseni, Arlind Çaçani, Vasil Sterjovski, artemis Dralo(Malo).

Mungojnë:

Arben Kamami, Sadri Abazi

Të ftuar:

Reida Kashta – Drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë së Prokurimit Publik

Xhoana Ristani – Përgjegjëse e Sektorit të Integritit në Agjencinë e Prokurimit Publik

Joanid Myzyri – Kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik

HAPET MBLEDHJA

Rudina Hajdari – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Integritit European.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, do të bëjmë listëprezencën për të parë se kush nga deputetët është prezent dhe më pas do të vazhdojmë me shqyrtimin e projektligjit që kemi për sot.

Prezentë janë deputetët: Senida Mesi, Fatmir Velaj, Ilir Pendavinji, Taulant Balla, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Mirela Kumbaro, Sadri Abazi, Ralf Gjoni, Nikolin Staka, Kostaq Papa, Edlira Hyseni, Arlind Çaçani, Vasil Sterjovski, Musa Ulqini dhe Majlinda Halilaj.

Zonja Halilaj, pse jeni prezente në mbledhje? A keni ardhur si dëgjuese?

Majlinda Halilaj – Po.

Arlind Çaçani – Ka propozuar një amendament.

Rudina Hajdari – Kush ka bërë amendament?

Zoti Çaçani, a thatë diçka?

Sipas Rregullores, zonja Halilaj nuk ka të drejtë vote, por thjesht është vëzhguese në këtë mbledhje.

Atëherë, fillojmë mbledhjen.

Fillimisht kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Kush është dakord me procesverbalin e datës 30.10.2020?

Miratohet.

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për prokurimin publik”.

Të ftuar për këtë projektligj kemi zonjën Reida Kashta, drejtoreshë e Përgjithshme e Agjencisë së Prokurimit Publik, zonjën Xhoana Ristani, përgjegjëse e Sektorit të Integritit, po ashtu, kemi edhe zotin Joanid Myzyri, kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik.

Atëherë, kush e do fjalën për të prezantuar projektligjin?

Reida Kashta – A mundem?

Rudina Hajdari – Po, zonja Kashta.

Reida Kashta – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Projektligji që paraqitet sot për miratim në Komisionin e Integritetit është një projektligj i ri për procedurat e prokurimit publik. Ky projektligj synon dhe vjen në kuadër të dy drejtimeve kryesore: së pari, të ndryshojë dhe të përmirësojë sistemin e prokurimit, në të cilin ne operojmë aktualisht dhe, së dyti, të përafrojë më tej legjislacionin shqiptar me direktivat përkatëse të BE-së.

Konkretisht, ky ligj përafuron 4 direktiva të BE-së, dy prej tyre në fushën e prokurimit klasik dhe dy të tjera në fushën e prokurimit utilitar.

Çfarë synon projektligji dhe risitë kryesore të tij janë:

Qartësimi i fushës së zbatimit të ligjit, përjashtimet specifike dhe kontrata të përziera të prokurimit.

Parashikimi për herë të parë i konceptit të kontratave të rezervuara dhe kontratave ndërmjet subjekteve brenda sektorit publik; kontrata këto që vijnë nga direktivat përkatëse të BE-së.

Gjithashtu, parashikon për herë të parë njoftimet paraprake dhe periodike të informacionit dhe synon të rrisë transparencën në procesin e prokurimit. Këto koncepte dhe procese bazohen nga direktiva e BE-së drejt frymës së transparencës në këtë proces.

Në projektligj parashikohet që kufijtë monetarë do të përcaktohen në legjislacionin dytësor dhe do të jenë po ashtu sipas direktivave të BE-së, duke i ndarë procedurat në: procedura për kufirin e lartë monetar, kur detyrimet e parashikuara sipas direktivave janë të zbatueshme në masën 100% dhe procedura nën kufijtë e lartë monetarë, kur procedurat që konsiderohen të brendshme respektojnë parimet e transparencës, konkurrencës, pra trajtim i barabartë që konsiderohen dhe synohen të bëhen më të lehtësuara.

Gjithashtu, në këtë projektligj për herë të parë parashikohen të gjitha llojet e procedurave të prokurimit që parashikojnë direktivat duke shtuar këtu për herë të parë: procedurën konkurruese me negociim, dialogun konkurrues dhe partneritetin për inovacion; procedura këto që huazohen nga direktivat përkatëse.

Synohen procedura më të thjeshtuara në prokurimin e veprimtarive të sektorit utilitar, që janë sektorët që kanë të bëjnë me shërbimet e transportit, ujit, energjisë, gazit, shërbimet postare, portet dhe aeroportet. Këto janë shërbime dhe procedura që i kemi të parashikuara aktualisht në legjislacion, por nuk vijnë në përputhje 100% me direktivën përkatëse të BE-së dhe në këtë projektligj synohet që të kemi përafrim sa më të plotë drejt këtyre parashikimeve.

Gjithashtu, synojmë lehtësimin e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në procesin e prokurimit, duke shfaqur për herë të parë në këtë projektligj konceptin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sikurse e parashikon edhe direktiva e BE-së.

Parashikohet për herë të parë dhe synohet nxitja e zbatimit të ofertës ekonomikisht më të ulët, duke u munduar të ndryshojmë praktikën e deritanishme, ku në 99% të rasteve e zbatojnë vetëm çmimin më të ulët.

Në këtë projektligj shtojmë, saktësojmë dhe detajojmë konceptin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, sikurse bëjnë edhe direktivat përkatëse të BE-së. Rikthejmë sigurimin e ofertës, koncept të cilin e kemi hequr prej vitit 2012, por nga praktika rezultonte se i nxiste operatorët ekonomikë drejt veprimeve të papërgjegjshme, duke qenë se nuk kishin penalitete. Kështu që rikthejmë konceptin e sigurimit të ofertës, sikurse e kanë direktivat.

Për herë të parë vendosim konceptin e prokurimeve në fushën sociale dhe të veçantat. Direktiva parashikon një kapitull të posaçëm për këto lloje prokurimesh, duke parashikuar rregulla shumë të lehtësuara. Me këtë synojmë të rregullojmë një problematikë të shfaqur ndër vite në praktikë, ku prokurimet në fushën sociale duke qenë se kanë një specifikë të posaçme dhe duhet të jenë shumë më të lehtësuara ne nuk kemi aktualisht një rregullim të posaçëm dhe për herë të parë po e sjellim si një kapitull të veçantë në përputhje me parashikimet e direktivës. Shpresojmë shumë që ky lloj rregullimi i posaçëm i prokurimeve në fushën sociale të rregullojë praktikën e përditshme të disa institucioneve që operojnë në këtë drejtim.

Gjithashtu, parashikojmë për herë të parë një periudhë pritjeje në procesin e ankimit, të cilin nuk e kemi 100% sipas direktivës, por në legjislacionin e ri e vendosim 100% sipas direktivës, periudhë në të cilën askush nuk mund të veprojë me autoritetet kontraktore, për sa kohë kemi proces ankimi dhe duhet të kemi vendimmarrjen finale nga institucioni kompetent, që është Komisioni i Prokurimit Publik.

Gjithashtu, për herë të parë vendosim ankimin njëkohësisht në autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Pra, kemi ankimin me një shkallë, jo me dy shkallë, siç e kemi tani. Me këtë synojmë të shkurtrojmë afatet e ankimit dhe të rrisim performancën e procesit të ankimit. Për herë të parë vendosim që ankimet kundër vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik të shkojnë direkt në Gjykatën e Apelit dhe jo në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative, duke ia dhënë të plotë atributin Komisionit të Prokurimit Publik, si organ *quasi* gjykatë në këtë rast.

Vendosim konceptin e modifikimit të kontratave, sikurse e ka direktiva.

Së fundi, jemi munduar të saktësojmë dhe të parashikojmë në projektligj për herë të parë kompetenca, të cilat synojnë mirërregullimin e zbatimit të kontratave, të cilat me legjislacionin aktual nuk janë të rregulluara. Pra, synojmë që në këtë projektligj të kemi të mbuluar rregullimin që nga faza fillestare e studimit të tregut dhe përcaktimit të nevojave deri në fazën finale, që është qëllimi kryesor i procesit të hartimit të një kontrate në përputhje me kushtet për të cilat është konkurruar dhe është fituar kontrata publike.

Ajo që unë dua të theksoj është se puna 2-vjeçare për hartimin e këtij projektligji ka qenë një sfidë më vete, ku grupi i punës është kryesuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, por kanë qenë anëtare një sërë ministrish. Dy kanë qenë gjërat kryesore: së pari, të përfronim këtë projektligj me direktivat përkatëse. Do të ishte shumë e thjeshtë ta kopjonim ligjin nga direktivat dhe ta servirnim për zbatim, por do ta bënte të pamundur zbatimin e ligjit. Kështu që sfida jonë ka qenë përshtatja e parashikimeve në direktiva, të cilat siç dihen rregullojnë marrëdhënie midis shteteve me një legjislacion të brendshëm që synon të rregullojë një proces prokurimi brenda Shqipërisë dhe në kontekstin në të cilin ne jemi.

Së dyti, jemi munduar shumë për këtë projektligj, pasi kemi marrë jo vetëm konsultime me Komisionin Europian, me Bankën Botërore, me Këshillin e Europës, me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, por në mënyrë të herëpashershme dhe të njëtrajtshme kemi marrë konsultime nga ekspertë të SIGMA-s dhe Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri për t'u siguruar që ligji vjen në përputhje, në linjë dhe në të njëjtën frymë me direktivat përkatëse të BE-së, sigurisht, duke u përshtatur dhe jo kopjuar me kontekstin në të cilin ne jemi.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja Kashta, për prezantimin!

Nëse përfaqësuesit që kanë ardhur nga sektori i integritetit kanë diçka tjetër për të shtuar, ky është momenti në lidhje me prezantimin e projektligjit. Nëse jo, atëherë do të kalojmë te zoti Kasneci, i cili është drejtor i Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit. Unë do të doja një mendim nga zoti Kasneci dhe më pas do të vazhdojmë me pyetje dhe përgjigje nga deputetët.

Zoti Kasneci, a jeni në linjë?

Hap mikrofonin, të lutem!

Nuk ju dëgjojmë, ndaj dilni dhe rifutuni përsëri në linjë.

Rudina Hajdari – Po, zoti Kasneci hapeni mikrofonin. Sërish nuk dëgjoheni. Është hera e dyta që e keni këtë problem, prandaj para se të filloni mbledhjen duhet ta kontrolloni anën teknike, sepse janë shumë njerëz në linjë dhe nuk mundën t'ju presin ju derisa të rregulloni mikrofonin.

Ju lutem, këto probleme duhen rregulluar para se të fillojë mbledhja. Po fillojmë me pyetjet e deputetëve.

Unë kam disa pyetje për Agjencinë e Prokurimit Publik për këtë projektligj. Po filloj unë e para, pastaj do t'ua kaloj fjalën deputetëve. Më pas, zoti Kasneci mund të na japë mendimin e tij.

Po më thonë që është lidhur, e provojmë edhe një herë.

Dedë Kasneci – Përshëndetje!

Rudina Hajdari – Po, zoti Kasneci tani dëgjoheni. Ju lutem na thoni opinionin tuaj për projektligjin.

Faleminderit!

Dedë Kasneci – Zonja kryetare, ju kërkoj ndjesë juve dhe pjesëmarrësve në këtë mbledhje për problemin teknik. Në çdo mbledhje ne duhet të marrim pajisjet nga IT-ia, sepse nuk kemi infrastrukturë të përshtatshme, prandaj ju kërkoj ndjesë. Kuptohet në situatë pandemie ndodhin këto gjëra.

Siç u prezantua edhe nga drejtoresha e Agjencisë së Prokurimit Publik, pra nga përfaqësuesja e qeverisë, një nga qëllimet e projektligjit për prokurimin publik është edhe përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e prokurimit publik, si dhe përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar në fushën e prokurimit publik me legjislacionin e Bashkimit Europian. Konkretisht, projektligji është përafruar me katër direktiva, me direktivën nr. 24 të vitit 2014 për prokurimin publik, ose siç quhet ndryshe: direktiva që mbulon procedurat e prokurimit publik në sektorin klasik.

Është përafruar me direktivën nr. 24/ 2014, e miratuar në të njëjtën datë me direktivën tjetër për prokurimin publik, për entet që veprojnë në sektorin e ujit, të energjisë, transportit dhe shërbimeve postare, pra, direktiva që mbulon procedurat e prokurimit në atë që quhen sektori i shërbimeve publike ose fusha sektoriale.

Është përafruar me direktivën nr. 665/1989, e cila është direktiva e ankesave lidhur me procedurat e prokurimit në sektorin klasik.

Gjithashtu, është përafuar edhe me direktivën nr. 13, të vitit 1992, e cila parashikon procedurat e ankimit në sektorin e shërbimeve publike, pra në sektorin e ujit, të energjisë, transportit dhe telekumunikacionit.

Shërbimi ynë në mbështetje të veprimtarisë suaj ligjvënëse, e nderuara zonja kryetare dhe të nderuar deputetë, ka analizuar përputhshmërinë e dispozitave të projektligjit me aktet përkatëse të BE-së. Për një përafrim më korrekt, ne kemi paraqitur në total 20 sugjerime ose amendamente. Këto i kemi diskutuar paraprakisht edhe me përfaqësuesit e qeverisë, pra me Agjencinë e Prokurimit Publik. Nga një komunikim i minutave fundit, mund të them se Agjencia e Prokurimit Publik, konfirmon 17 vërejtje tonat, ndërsa për 3 raste ka paraqitur argumentet e saj. Ne i qëndrojmë versionit tonë që kemi paraqitur dhe më tej do të diskutojmë. Pra, vendimmarrja është juaja, e nderuara zonja kryetare dhe të nderuar deputetë.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Kasneci për opinionin tuaj!

Do të fillojmë me pyetjet për zonjën Kashta dhe për përfaqësuesit e tjerë që kanë ardhur në këtë mbledhje.

Zonja Kashta, ky projektligj ka ardhur si kërkesë edhe e Bashkimit Europain. Për sa i përket procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, kapitulli i pestë ka të bëjë pikërisht me prokurimin publik.

Në raportin e komisionit të BE-së, vit pas viti janë dhënë këshilla apo komente në lidhje me ligjin e prokurimit publik. Në opinionin tuaj, apo në opinionin e komisionerit, si ka mundësi që sipas Komisionit Europian, ka pasur një rënie të ofertave për tender, i cili në vitin 2019 në raport me vitin 2018 rezulton që ka rënë. Këtu jepen me përqindje. Në vitin 2018 thuhet 3% kurse në vitin 2019 rreth 2,7%. Po t'i vendosim këto përqindje në numra, shikojmë që në vitin 2018 ka 531 oferta dhe në vitin 2019 kanë rënë në 192 oferta. Po të marrësh vitin 2017 si vit krahasues, në këtë vit ka pasur 2234 oferta për tender, pra si ka mundësi që nga viti 2017 në vitin 2019 kanë rënë ofertat në mënyrë drastike? Pra, pse ka rënë konkurrenca në treg, sipas opinionin tuaj? Si reflektohet kjo, pra si do ta nxisni ju konkurrencën në treg për tender?

Faleminderit!

Reida Kashta – Ju falënderoj për pyetjet. Ajo që thuhet në progresraportin e Komisionit Europian për kapitullin 5, i cili është një kapitull me të cilin qeveria shqiptare do të punojë për procesin e integritetit, i referohet numrit të procedurave me negociim pa shpallje.

Nëse do të shikojmë progresraportet nga viti 2017 e në vijim, një nga shqetësimet e ngritura nga Komisioni European në progresraport është rritja e numrit të procedurave me negociim pa shpallje, të cilat konsiderohen si procedura më pak konkurruese dhe ky është një shqetësim. Në këtë kuptim, nga vlerësimi i qeverisë shqiptare në fushën e prokurimit, në vitin 2020, progresraporti vlerëson uljen e numrit të procedurave me procedim pa shpallje. Pra, Komisioni European, shprehet që duke u nisur nga monitorimi nga afër dhe i vazhdueshëm i procesit, është arritur që numri i procedurave me procedim pa shpallje të ulet në 192 për vitin 2019, nga 513 që ka qenë në vitin 2018 dhe nga 2234 që ka qenë në vitin 2017. Pra, kjo është një arritje, që me punë të vazhdueshme prej vitit 2017 e në vijim kemi arritur të ulim numrin e procedurave me negociim pa shpallje, duke rritur në mënyrë indirekte numrin e procedurave konkurruese. Pra, këto shifra i referohen qeverisë shqiptare, si vlerësim në progresraport. Në një historik që kemi prej vitit 2009 deri në vitin 2019, për herë të parë kemi një ulje në vitin 2019 në nivelet e 2,3%, nëse nuk gaboj, në përqindjen të këtij numri, nga mesatarja 30% që ka qenë nga viti 2009 deri në vitin 2017 e procedurave me negociim pa shpallje. Pra, besoj realisht që këto shifra në progresraport i referohen arritjeve. Besoj shumë që ndryshimet që po sjellim do të na çojnë akoma më shumë në përmirësimin e procesit, jo vetëm në uljen e numrit të procedurave me negociim pa shpallje, që tashmë është një fakt dhe është i thënë qartazi në progresraport, por edhe në rritjen e performancës në të gjitha aspektet e tjera të prokurimit. Ky është edhe qëllimi ynë, pra të përmirësojmë më tej procesin e prokurimeve me këtë ligj.

Rudina Hajdari – Pra, në dijeninë tuaj gjatë këtyre viteve nuk ka rënë konkurrenca. Këtë po më konfirmoni?

Reida Kashta – Në fakt, unë ju ktheva përgjigje për shifrat konkrete që ju më referuat nga progresraporti dhe ato shifra i referohen uljes së numrit të negociimeve.

Nëse do të komentojmë për konkurrencën, këto janë të dhëna të tjera dhe ne duhet të flasim me të dhëna përkatëse, që nuk i kam konkretisht, por një nga synimet e këtij projektligji është...

Rudina Hajdari – Si ka mundësi që nuk i keni, duke qenë se jeni edhe agjencia që merret me monitorim?

Reida Kashta – Jo, nuk i kam tani përpara, sepse patjetër që i kemi të dhënat, por më duhet t'i gjej.

Rudina Hajdari – Në dijeninë tuaj a ka pasur rënie në treg në lidhje me ofertat që ju kanë ardhur si me tenderët pa shpallje, ashtu dhe me shpallje, a ka pasur rënie në këto vite në këtë

trajektore nga viti 2017 në vitin 2018, 2019 dhe 2020 të konkurrencës në dijeninë tuaj? Nëse ka pasur, a keni ndonjë propozim konkret në këtë projektligj, ku do të nxisni konkurrencën në treg?

Reida Kashta - Mesatarja e ofertave në tre vjetët e fundit rri te 3% dhe kjo rri te procedurat mbi kufirin e ulët monetar, ndërkohë nën kufirin e ulët monetar mesatarja e ofertave është 12%. Megjithatë, edhe këtë ne e konsiderojmë si një aspekt të procesit të prokurimit, që duhet përmirësuar dhe tri janë elementet kryesore që kemi ndërmarrë në këtë projektligj, që synojnë nxitjen e mëtejshme të mesatares së ofertave mbi procedurë prokurimi, mesatares në të gjithë sistemin dhe të rritjes së ofertave konkrete në procedura prokurimi.

Tri elementet kryesore janë: qartësimi i mënyrës se si do të bëhet studimi i tregut, sepse një proces fillon nga studimi i tregut, sa më i qartë, koherent dhe real të jetë studimi i tregut, aq më koherent dhe real do të jetë procesi i prokurimit mbi të cilin zhvillohet konkursi. I dyti dhe që është më rëndësishmi, është hartimi i specifikimeve teknike dhe i kriterëve. Ky është cilësi i një procesi prokurimi. Sa më të qarta dhe gjithëpërfshirëse të jenë kriteret dhe specifikimet teknike në një procedurë prokurimi, aq më shumë nxitet potencialisht konkurrenca në treg. Për të realizuar këtë lloj qëllimi, ne, përveç parashikimeve konkrete, sipas direktivës dhe modeleve të vendeve të tjerat e BE-së, për herë të parë me këtë legjislacion do të nxisim edhe argumentimin e kriterëve nga çdo autoriteti kontraktor dhe detyrimin e tyre që t'i publikojnë bashkë me kriteret. Pra, nuk do të publikohen më, sipas legjislacionit të ri, vetëm kriteret që janë vendosur mbi procedurë, por autoritetet do të keni detyrimin të publikojnë edhe procesverbalin që argumenton kriteret, bazën ligjore, ku e bazojnë kriterin, argumentin logjik dhe teknik, që ata kanë mbi kriterin që të rritet përgjegjshmëria e autoritetit kur bën një kriter mbi një tender dhe, nga ana tjetër, të rritet mekanizmi i kontrollit nga palët e treta mbi këtë autoritet kur harton kriteret. Mendojmë se ky do të jetë një nga proceset, që do të ndikojë drejtpërdrejt në hartim kriteresh të ligjshme, që do të nxisin konkurrencën, nga ana tjetër.

Gjithashtu, një aspekte tjetër që duhet të kemi në vëmendje kur flasim për mesatare ofertash apo konkurrueshmërinë në një proces prokurimi, duhet të jetë edhe tregu, sepse kemi dy palë në proces, që janë autoritetet kontraktore, pala publike, që ne normojmë më rregulla, por duhet të mbajmë në vëmendje edhe sjelljen e tregut. Për këtë ne duhet të nxisim treg të përgjegjshëm, pra operatorë ekonomikë që hyjnë pa bërë marrëveshje të fshehta mes tyre, që është një problem që nuk ekziston vetëm në Shqipëri, por në çdo vend të botës dhe ndjeshëm edhe në vendet e BE-së. Kështu që, ne duhet të gjejmë mekanizma se si të shmangim marrëveshjet e fshehta mes

operatorëve ekonomikë për të hyrë apo për të bërë rotacione në procese prokurimi dhe për të bërë tërheqja, apo mostërheqje nga proceset e prokurimit. Për këtë arsye në këtë ligj, për herë të parë, vendosim, ndër të tjera, që operatorëve ekonomikë, e para, nëse tërhiqen nga tenderi, u mbahet sigurimi i ofertës, e dyta, nëse operatorët ekonomikë shkojnë deri te faza e para lidhjes së kontratës dhe tërhiqen pa arsye për lidhjen e kontratës, potencialisht mund të jetë një lojë e fshehtë për t'ia lënë radhën operatorit të radhës, pra nëse tërhiqet nga një autoritet kontraktor do të skualifikohet nga ky autoriteti për të gjithë vitin, nëse tërhiqet 5 herë në autoritete të ndryshme në të gjithë Shqipërinë do të përjashtohet nga Agjencia e Prokurimit Publik për tre vjet. Pra, mekanizma që synojnë të nxisin përgjegjshmërinë e veprimeve të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi. Edhe kur ofertojnë duhet të jenë më të përgjegjshëm, për të shmangur ofertimet e papërgjegjshme, apo ofertime që bëhen thjesht për të çorientuar procesin e prokurimit. Mendoj që këto janë tre elementet kryesore që ne synojmë dhe pretendojmë që do të na nxisin konkurrencën në proces prokurimi, por ajo që dua të theksoj është që konkurrenca në proces prokurimi nuk varet vetëm nga njëra palë.

Rudina Hajdari – Dakord.

Sipas këtij raporti, që citova pak më sipër, në raportin e vitit 2019 thuhet që ka pasur parregullsi në procedurat e prokurimit dhe, megjithëse kjo ka ndodhur, pra ka pasur parregullsi, ka pasur edhe një rritje të shpenzimeve, pra nga 12 milionë euro në 2017-n ka shkuar në 13,9 milionë euro në 2019-n. Si e justifikoni këtë rritje, ndërkohë që ka pasur probleme me këtë ligj?

Reida Kashta – Nuk jam e sigurt nëse e kuptova qartë, por po thoni që ka rritje shpenzimesh në proces prokurimi?

Rudina Hajdari – Po.

Reida Kashta – Shpenzime në kuptimin lekë të shpenzuara nëpërmjet procesit?

Rudina Hajdari – Nëpërmjet procesit që ju keni dhënë për tender. Keni shkuar nga 12 milionë euro në 2017-n në 13,9 milionë euro në 2019-n. A po e citoj në mënyrë korrekte?

Reida Kashta – Nuk jam e sigurt nëse po flasim për fonde të shpenzuara nëpërmjet procesit të prokurimit dhe është rritur fondi i shpenzuar në procesin e prokurimit. Nëse u referohemi të dhënave të Komisionit Europian, u referohet te gjitha kategorive të institucioneve, pra çdo institucion është kompetent, ka diskrecion dhe përgjegjësi në atë që prokuron.

Rudina Hajdari – Koston totale.

Reida Kashta – Jo vlerën. Ndjesë, se nuk e kam progresraportin përpara, duke qenë se prezantoj ligjin, por nuk jam e sigurt nëse...

Rudina Hajdari – E kishit përpara, sepse sapo e cituat...

Rudina Hajdari – Janë shifrat e negocimit, të cilat ne i kemi arritje dhe unë i kam përpara syve. Megjithatë, nëse i referohemi faktit që ka rritje të vlerës së shpenzuar nëpërmjet procesit të prokurimit, kjo nuk është shkelje. Nëse ajo që po referojmë është keqpërdorim fondesh, pra nëse shprehja apo diskutimi juaj është që janë rritur fondet që janë keqpërdorur, dhe nuk e di nëse progresraporti në atë moment i referohet raportit të KLSH-së.

Rudina Hajdari – A doni ta citoj?

Reida Kashta – Po, të lutem!

Rudina Hajdari – Atëherë, raporti i vitit 2019 thotë: “Autoritetet kontraktuese kanë mungesë kapacitetesh për të menaxhuar në mënyrë efektive proceset e prokurimit publik. Pajtueshmëria është ende përgjithësisht e dobët, veçanërisht në procedurat më komplekse”. Mund të na shpjegoni pse është kjo? “Është vërejtur progres në lidhje me integritetin dhe konfliktin e interesave. APP-ja ka nxjerrë tashmë disa udhëzime për deklarimin e konfliktit të interesit për zyrat e prokurimeve, për më tepër ajo miratoi një rregullore...”. Tani, fjalia që vjen më pas: “KLSH-ja raportoi një numër të konsiderueshëm parregullsish në proceset e prokurimit publik me një humbje të vlerësuar të buxhetit të shtetit prej rreth 13,9 milionë euro në vitin 2019, krahasuar me 9,4 milionë euro në vitin 2018 dhe 12 milionë euro në vitin 2017”.

Kësaj po i referohem.

Reida Kashta – Faleminderit!

Po i marr me radhë.

Referencës së bërë në progresraport për mungesë kapacitetesh, është nxjerrë si një nga rekomandimet e progresraportit, që duhet të nxitet rritja e kapaciteteve për administratën, për gjykatën dhe për KLSH-në vetë, dhe po të lexohet progresraporti deri në fund kërkohet nxitje, që është një nevojë e vazhdueshme, nëse flasim për prokurimet, për ngritje kapacitetesh. Në këtë drejtim në ligjin e ri të prokurimit për herë të parë ne fusim konceptin e profesionalizimit, duke qenë se mendojmë që kjo është një nga hallkat, e cila ka nevojë për rregullim në të gjithë sistemin, të profesionalizohet kompetenca e një punonjësi që është adapt për të kryer procedura prokurimi, të certifikohet nëpërmjet një sistemi të mirëfilltë trajnimi dhe certifikimi dhe vetëm ata të jenë të

pajtueshëm me kryerjen e funksioneve të procesit të prokurimit publik në administratën publike apo kudo që të ketë një autoriteti kontraktor.

Ne kemi një synim dhe një hap konkret në ligjin e ri, ku synojmë të rregullojmë procesin e ngritjes së kapaciteteve. Ndërkohë që me institucionet e tjera, si gjykata apo KLSH-ja, vazhdojmë komunikimin me ngritjen e kapaciteteve nëpërmjet Shkollës së Magjistraturës, nëpërmjet projekteve të ndryshme, që asistojnë prokurorë dhe gjyqtarë, si dhe kemi një komunikim tashmë pas progresraportit, edhe me KLSH-në, ku i kemi kërkuar bashkëpunimin për të ngritur kapacitetet. Kjo është e lidhur me pikën e dytë, pra ka një koment për pajtueshmëri të dobët për procedura komplekse.

Legjislacioni dhe ligji i ri synojnë të risin performancën në të gjithë procesin dhe në të gjithë sistemin e prokurimit publik. Të dyja këto janë të lidhura bashkë me atë që citohet aty. Pra ky nuk është një mendim i Komisionit Europian, por citon një fakt të pretenduar nga KLSH-ja dhe fakti është absolutisht një fakt i pretenduar. Në bazë të legjislacionit shqiptar, nëse vlerësohet apo jo dëmi ekonomik, kjo vlerësohet vetëm me një vendim gjykate. Pra, nuk vlerësohet dot nga askush, nga asnjë organ i administratës publike. Por KLSH-ja ka një pretendim për mënyrën si ka bërë auditimet e tij dhe bën diferencat matematikore nga oferta më e ulët, është ajo, apo jo në përputhje me kriteret për kualifikim, me ofertën që është shpallur fituese.

Unë nuk kam një koment nga pikëpamja profesionale, të dakordësoj apo jo mbi faktin e pretenduar nga KLSH-ja dhe të referuar në Komisionin e Prokurimit Publik, sepse më duhet të bëj një hetim të posaçëm për çdo procedurë, për të thënë nëse ka apo jo shkelje në proces dhe nëse kjo shkelje ka shkaktuar dëm ekonomik, i cili duhet të dokumentohet dhe të legjitimohet me një vendim gjykate.

Megjithatë, ajo që mund të them është që në ligjin e ri, që propozojmë, synojmë patjetër rritje të performancës në çdo drejtim të procesit të prokurimit.

Rudina Hajdari – Dakord.

Po ashtu, ky raport thotë: “Ligji shqiptar ende nuk ka dispozita për mungesën e efektivitetit të kontratave, dënimet alternative dhe njoftimet vullnetare të transparencës”. Domethënë, ky problem vazhdon të jetë. Si do ta zgjidhni ju mungesën e efektivitetit të kontratave që është një problem, sipas raportit të BE-së, por edhe për ne që jetojmë këtu dhe e kemi parë?

Reida Kashta – Po, janë të dyja çështje, të cilat ne i adresojmë në ligjin e ri. Njoftimin vullnetar unë përmenda edhe në prezantimin paraprak si një risi në ligjin e prokurimit, pra për herë

të parë parashikojmë konceptimin e njoftimit paraprak dhe vullnetar në procesin e prokurimit në dy drejtime: edhe në procedurat konkurruese, më saktë me këtë ligj nxiten autoritetet dhe bëjnë njoftime paraprake për t'i dhënë shumë informacion dhe kohë palës private për t'u bërë aktivë dhe pjesëmarrës në procesin e prokurimit.

Një tjetër risi është se edhe procesi i negocimit pa shpallje; është një procedurë, e cila, sikurse e diskutuam, konsiderohet problematike. Pavarësisht se ne e kemi ulur numrin, kemi nevojë për rritje transparence në të dhe koncepti që fusim për herë të parë sipas direktivës është njoftimi vullnetar. Pra, pavarësisht se jemi në procedurë me negocim pa shpallje, ligjërisht nuk detyrohet institucioni të bëjë një shpallje, sepse e vë në kushte të caktuara që vendos ligji, prandaj kemi futur konceptin e njoftimit vullnetar. Pra, stimulohen autoritetet kontraktore ta bëjnë publik këtë informacion, edhe pse janë në kushtet e përdorimit të një procedure me negocim pa shpallje.

Së dyti, në lidhje me pavlefshmërinë e kontratave, për herë të parë fusim këtë koncept me një nen të posaçëm dhe, sikurse direktiva përkatëse e kërkon, këtë proces, nëse vlerësohen kushtet, do ta vendosë Komisioni i Prokurimit Publik dhe ka parashikuar shumë qartë kushtet të cilat vendosen kur një kontratë të shpallet e pavlefshme. Pra, janë të dyja çështje të ngritura nga progresraporti i Komisionit European, të cilat adresohen në këtë ligj.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Besoj se me kaq unë i përfundova pyetjet e mia.

A ka pyetje të tjera nga deputetët për zonjën Kashta?

Zonja Hyseni.

Edlira Hyseni – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, nuk e kisha në plan ndërhyrjen, por më bëri përshtypje komenti që përfaqësuesja e lartë e qeverisë u bëri rekomandimeve ose gjetjeve që ka bërë raporti i KLSH-së për çështjen në fjalë. Në fakt, m'u duk jo e pranueshme, jo e zakonshme që i quan thjesht fakte të pretenduara gjetjet e auditimit. KLSH-ja është një institucion i pavarur, por raporti i auditimit është mjaft i rëndësishëm qoftë për buxhetin shtetit, por edhe për të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale. Nuk është një punë e bërë thjesht për të dhënë një rekomandim atje si një fakt të pretenduar, por duhet një gjykatë për ta vërtetuar. Më bëri shumë përshtypje reduktimi që ju i bëni punës së KLSH-së dhe gjetjeve që bën KLSH-ja. KLSH-ja i ka gjetjet materiale me natyrë të rëndësishme sasiore dhe cilësore dhe, përtej rekomandimeve, duhet të përbëjë për ju një kampanë alarmi ose një detyrë. Madje, janë detyra që ju lihen, ku nuk ka nevojë që gjykata të bëjë në çdo

rast ndërhyrjet e saj, por jeni ju që besoj, si institucion mjaft i rëndësishëm në procedurat e prokurimeve publike, duhet të merrni masat tuaja të auditimit të brendshëm, të kontrolleve tuaja për të parë se sa qëndrojnë problematikat që ngreh KLSH-ja. Realisht, ky reduktim e ky zhvlerësim që ju i bëni raportit të KLSH-së në lidhje me gjetjet e vitit 2019, që sapo e kemi pasur në dorë, më duket ofendues për punë e tyre dhe shumë jo shumë i përshtatshëm për t'u shprehur. Me këtë rast edhe unë po ju pyes, meqenëse ligji që vjen është mjaft i rëndësishëm dhe lidhet me prokurimet publike. Të gjithë e dimë, se jetojmë në një realitet, ku dihet që është “Thembra e Akilit”, pra një nga ato çështjet madhore për të cilat ka gjithmonë skepticizëm, dilema, mosbesim e të tjera. Ligji i ri bëhet në frymën e përshtatjes me legjisllacionin e Bashkimit European dhe shpresojmë që do ta përmirësojë cilësinë e prokurimeve publike. Dy elementet, që besoj se mbeten boshtet kryesore mbi të cilat përpiqen të bëhen ndryshimet cilësore, janë lufta, ose mundësia për të shmangur korrupsion dhe si do të përzgjidhet oferta më e mirë ekonomike. Në fund të fundit, synimi në aspektin financiar është të arrihet në përzgjedhjen e ofertës më ekonomike, më me leverdi, por në një garë të lirë dhe të barabartë midis operatorëve ekonomikë. Pra, këta janë objektivat kryesorë, pra gara të jetë për të gjithë e hapur, të jetë e lirë, e garantuar, e barabartë dhe të arrihet në një ofertë ekonomikisht të vlefshme, më e mira e mundshme për të kryer një shërbim apo për të ofruar një mall të caktuar nëpërmjet procedurave që bëhen. A mund të më thoni ju, në gjykimin tuaj, si zgjidhet ose cilat janë pikat kyçe që do të zgjidhin ose që ju mendoni se do ta përmirësojnë, ose do ta zgjidhin definitivisht problemin e korrupsionit që ka vendi dhe të gjithë e ngrenë si problematikë në lidhje me tenderët dhe prokurimet publike? Si do të arrihet për përmirësimin e ofertës më të mirë dhe për një konkurrencë më të lirë midis operatorëve, ku garat të mos jenë paraprakisht të vendosura apo që tenderët bëhen me kushte kur dihet se kush do ta fitojë në fund atë tender? Pra, si do të shmangen ato abuzime që deri më sot janë fakte? Me këtë ligj të ri unë ju uroj punë të mbarë, por ju ftoj që gjetjet dhe rekomandimet e KLSH-së t'i merrni më seriozisht se sa thjesht si fakte të pretenduara.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Zonja Kashta, fjala për ju.

Reida Kashta – Faleminderit!

Në fakt, thjesht për sqarim, sepse nuk besoj se ka nevojë për diskutim ajo që unë thashë, besoj se u keqlexua. Ajo që unë thashë për faktin e shprehur në progresraport, ishte një fakt i pakomentuar nga progresraporti. Sigurisht, vlerësimi i punës sonë për KLSH-në është maksimal

dhe kjo është shprehur në mënyrë të vazhdueshme me komunikimin dhe bashkëpunimin që kemi me ta. Për dijeninë tuaj, ne kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me ta edhe për çështje të ngritura për procesin e prokurimit. Megjithatë, këtu po flasim për dëm ekonomik dhe jo për shkelje procedurale. Kjo është ajo që unë thashë se nuk vlerësoj dot dhe nuk komentoj për fakte shifrash dhe dëmi ekonomik nuk është shkelje procedurale dhe që nga pikëpamja legjislative vendoset nga gjykata. Ky ishte komenti im, pavarësisht dhe besoj se nuk është rasti këtu të shpreh nivelin e bashkëpunimit që kemi me KLSH-në deri tani dhe përmirësimet që i kemi bërë këtij projektligji edhe për shkak të komenteve të KLSH-së. Ky projektligj është vlerësuar të konsultohet ngushtë me KLSH-në për shkak të rolit që kanë në këtë proces. Madje, po të shikohet historiku i dokumenteve, konsultimi i parë është bërë me KLSH-në, sepse donim këndvështrimin e tyre për ta ballafaquar më tej me komentet dhe opinionet e çdo institucioni tjetër apo aktori tjetër të përfshirë në këtë proces, duke e vlerësuar si një nga institucionet më të rëndësishme në vlerësimin apo arritjen e performancave të sistemeve të ndryshme dhe të sistemit të prokurimit në përgjithësi. Besoj se kemi kuptuar të njëjtën gjë me atë që unë thashë, atë që mendoj për KLSH-në për faktin e dëmit ekonomik.

Për t'u kthyer te pyetja juaj në lidhje me mekanizmat që do të ndikojnë në uljen e korrupsionit apo të perceptimit të korrupsionit në procesin e prokurimit publik, që është një proces apo perceptim i njohur apo i ditur nga të gjithë jo vetëm në Shqipëri, por në çdo vend, janë një sërë mekanizmash, me të cilat ne synojmë të rrisim eficiencën në prokurim dhe të shmangim korrupsionin. Kjo vjen që nga mënyra se si e normojmë më shumë transparencën e procesit dhe një nga hallkat e këtij procesi është se sa më shumë transparent ta bëjmë atë, që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në dy hallka.

Së pari, rrisim përgjegjshmërinë e autoriteteve kontraktore, sepse ato janë në lupën e vlerësimit të gjithkujt; së dyti, rrisim mundësinë e kontrollit nga çdo palë e interesuar. Kështu që ky është një nga elementet kyç të përmirësimit të procesit që do të ndikojë në luftimin e korrupsionit.

Ashtu sikurse e theksova dhe më parë, vënia e theksit te mënyra se si hartojmë kriteret është shumë e rëndësishme dhe thelbi i një procesi prokurimi në kushtet që fazat i fillojmë në mënyrë elektronike. Pra, ndikimi i impaktit njerëzor është shumë më i ulët, për sa kohë sistemin është dixhitalizuar, thelbi dhe kyçi ngelet te kriteret e procedurës. Prandaj fokusi ynë me këtë ligj të ri është orientuar atje që ne ta normojmë sa më shumë të jetë e mundur mënyrën e hartimit të

kritereve, nuk i standardizojmë. Kalojmë nga një procedurë në një tjetër në varësi të kërkesave e të nevojave, por jemi munduar t'i vendosim ato në një kornizë, për aq sa është mundur, duke ndjekur linjën e direktivave, por edhe modelet në aplikimet konkrete të vendeve të Bashkimit Europian dhe të rrisim monitorimin që u bëhet autoriteteve kontraktore kur hartojnë këto kritere. Dy do të jenë mekanizmat e kontrollit:

Së pari, ata do të detyrohen të publikojnë formatin e argumentimit të kriterit, i cili i vendos ata në kushte përgjegjshmëri shumë të forta në një moment përpara se të shpallin procedurën. Sigurisht, që ngel mekanizmi i rishikimit të kritereve nëpërmjet sistemeve të ankimit, që është një nga kompetencat kryesore të Komisionit të Prokurimit Publik dhe luan rolin e tij në përmirësimin e kritereve. Thelbi i nxitjes së konkurrencës dhe i shmangies së korrupsionit është kritere të mirëhartuara, të cilat nxisin gjithëpërfshirjen. Nga pikëpamja logjistike nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik kemi të garantuar mundësinë e ofertimit. Pra, askush nuk mund të ndalohet të ofertojë, të ketë akses në informacion. Gjithçka është e lidhur me përgatitjen dhe me përmbajtjen e procesit që fillon me hartimin e kritereve. Pra, këto janë dy pikat tona kryesore që ne të nxisim elemente sa më transparente për procesin. Për herë të parë kemi rregulluar shumë mirë sistemin e testimit të tregut dhe kjo është shumë e rëndësishme për të nxitur gjithëpërfshirjen e operatorëve që operojnë në treg dhe të normojmë sa më mirë dhe të nxisim mekanizma kontrolli në kriteret e procedurës.

Gjithashtu, nëse do ta mbyllnim ciklin, risia që sjell ligji është rritja e mekanizmave monitorues të zbatimit të kontratës. Pra, në qoftë se ne monitorojmë mirë zbatimin e kontratës, do të thotë që kemi marrë atë për të cilën kemi ofertuar, sepse, përndryshe mund të ndodhte të bënim një procedurë prokurimi, e cila mund të jetë bërë shumë bukur, por, nëse nuk e zbatojmë kontratën siç duhet, nuk kemi arritur asgjë dhe mund të nxiten elemente korruptive. Kështu që, nëse ne e mbyllim këtu ciklin, synojmë të përmirësojmë ndjeshëm eficiencën në të gjithë procesin.

Faleminderit!

Rudina Hajdari - Faleminderit, zonja Kashta!

Zonja Hyseni bëri pyetje dhe koment, por unë nuk arrij të mendoj se si rritja e kritereve rrit procesin për eliminimin e abuzimeve korruptive. Sa herë që përmenden problemet apo parregullsitë që ju keni, ju i neutralizoni duke thënë që këto probleme janë edhe në vende të tjera. E keni taktikë këtë gjë, ndërkohë që duhet t'u qëndrojmë problematikave që ekzistojnë, sepse prandaj ka lindur edhe nevoja e një ligjit të ri. Në momentin që ne dhe ju, si prezantuese në Kuvend,

e prezantojmë këtë projektligj dhe e miratojmë në Kuvend, duhet patjetër që të adresojmë edhe problematikat dhe të themi se ku ekzistojnë problemet. Edhe nëse problemet janë perceptuese, ato janë ekzistuese për shumë deputetë, të cilët kanë raporte me botën jashtë dhe e kuptojnë shumë mirë që këto probleme nuk ekzistojnë vetëm në shoqërinë tonë. Por ajo që dua të vë në dukje është mungesa e një përgjigjeje lidhur me këtë pyetje, pasi nuk kishte një përgjigje konkrete për mënyrën sesi ju do ta eliminoni uljen e abuzimit që bëhet me tenderët sot, ku sipas raportit të KLSH-së ka pasur një rritje të theksuar të abuzimit nga viti 2018 në vitin 2019. Përgjigjja juaj ishte tepër e vakët dhe jo shteruese, por, nëse keni dëshirë të shtoni diçka, mund t'ju jap këtë mundësi.

Një pyetje tjetër lidhur me kontratat, që diskutuam më sipër, është: si e monitoroni ju zbatimin e kontratave dhe si e parashikon ky projektligj i ri që këto kontrata të zbatohen deri në fund, të mos ketë abuzime dhe puna të shkojë deri në fund?

Faleminderit!

Reida Kashta – Faleminderit!

Ndoshta unë nuk isha shumë e qartë, por është e pamundur që t'ju jap një përgjigje vetëm me një fjali sesi mund të luftohet korrupsioni në procesin e prokurimit, ose se si mund të ulet perceptimi për korrupsionin në procesin e prokurimit, pasi është proces kompleks dhe duhet të ketë një sërë aktivitetesh, që bëhen në funksion të rritjes së performancës, rritjes së eficiencës dhe uljes së perceptimit të korrupsionit. Kjo është ajo që unë dua të shpjegoj është sesi ligji i ri, me parashikimet konkrete, e synon këtë gjë. Është e pamundur që të them se ulja e korrupsionit apo e perceptimit mbi korrupsionin do të bëhet nëpërmjet nenit x apo nenit y, por janë tërësia e parashikimeve dhe e veprimeve, që nga momenti fillestar kur hartohen nevojat dhe testohet tregu në një proces prokurimi, deri në momentin final, kur kemi marrë produktin, për të cilin është bërë procesi i prokurimit dhe e kemi marrë atë sipas kushteve për të cilat është konkurruar. I gjithë ligji në tërësinë e tij synon të arrijë këtë lloj rezultati.

Sa i përket zbatimit të kontratave, për herë të parë në këtë ligj parashikohet detyrimi i autoriteteve kontraktore që të raportojnë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik dhe, përveç kontratës, të hartojnë së bashku me kontraktorin fitues një plan sesi ata do ta zbatojnë kontratën. Kjo synon rritjen e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë së autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik. Pra, të kenë të detajuara hallkat dhe fazat që ata do të ndjekin gjatë fazës së zbatimit të kontratës. Kjo na rrit edhe mekanizmat e monitorimit. Përveç këtij plani që duhet të hartojnë, ata duhet ta raportojnë këtë fakt në Agjencinë e Prokurimit Publik në mënyrë të vazhdueshme deri

në momentin që finalizojnë kontratën. Kjo bëhet për t'u siguruar që kjo kontratë është zbatuar në përputhje me termat, për të cilën është shpallur fituese.

Te zbatimi i kontratës Agjencia e Prokurimit Publik ka një rol, për të cilin bashkëpunon shumë ngushtë me institucionet e tjera. Rol kryesor në kontrollin që ushtron nga pikëpamja financiare në zbatimet e kontratave ka KLSH-ja dhe Drejtoria e Inspektimit pranë Ministrisë së Financave. Pra, kemi një kombinim të punës së disa institucioneve.

Një nga sfidat tona ishte që të vendosnim kompetenca për Agjencinë, të cilat dakordësohen nga institucione të tjera dhe nuk mbivendosen me kompetencat e institucioneve të tjera. Agjencia ka parashikuar kompetenca të tilla, në mënyrë që të sigurohet që kontrata po raportohet dhe po realizohet në përputhje me kriteret për të cilat është konkurruar. Kjo është mënyra sesi janë parashikuar kompetencat e monitorimit të kontratës, nisur edhe nga modelet. Një parashikim i tillë është bërë për herë të parë, pasi nuk kemi pasur eksperiencë të mëparshme dhe sfida kemi zbatimin në praktikë të këtyre parashikimeve.

Jemi konsultuar ngushtësisht me përfaqësues dhe kolegë të Bashkimit European për të arritur në një parashikim konkret të tillë, në mënyrë që ta bëjmë të zbatueshëm në praktikë.

Synimi kryesor i yni është që të nxisim përgjegjshmërinë e autoriteteve kontraktore dhe operatorëve, si palë në kontratë, të zbatojnë kontratën në përputhje me termat për të cilat është konkurruar.

Faleminderit!

Rudina Hajdari - Faleminderit, zonja Kashta!

Fjala për zonjën Mesi.

Senida Mesi- Përshëndetje të gjithëve!

Falënderoj zonjën Kashta për të gjithë prezantimin!

Në fakt, ky projektligj është një risi dhe vjen në momentin e duhur, ndoshta duhet të vinte më herët, pavarësisht se kanë qenë dy vjet punë për këtë projektligj.

Unë e përgëzoj jo vetëm punën e Agjencisë, por edhe punën e ekspertëve, qoftë nga Bashkimi European, qoftë nga OECD-ja, që për hir të eksperiencës time kam një konsideratë maksimale për ekspertizën e shpejtë, të duhur dhe të saktë nga OECD-ja apo SIGMA.

U thanë shumë gjëra dhe nuk dua t'i përsëris, por dua të sqaroj me zonjën Kashta dy elemente shumë të rëndësishme: elementin e konkurrencës dhe të transparencës, pasi janë elemente shumë të rëndësishme, të cilat rrisin besueshmërinë te procesi, sepse, nga njëra anë, kemi

perceptimin dhe, nga ana tjetër, kemi raste konkrete dhe reale, të cilat janë denoncuar apo transmetuar qoftë nga KLSH-ja, qoftë nga drejtoritë e institucioneve apo nga drejtoria përkatëse e monitorimit të kontratave të Ministrisë e Financave.

Dua të përmend dy elemente të rëndësishme në ndryshimin e këtij projektligji, i cili përfron shumë direktiva dhe për këtë kam edhe dy pyetje më vonë për zotën Kasneci.

Zonja Kashta, u përmenden finalizime në lidhje me operatorët, por unë dua të di për kontraktuesit. Në qoftë se kontraktuesit mbyllin procesin pa një justifikim të arsyeshëm apo të bindshëm, qoftë për hir të ligjeve në fuqi, qoftë edhe për ju, si autoritet konkurrues që monitoroni të gjithë procesin, a do të ketë ndonjë penalizim në qoftë se në mes të procesit, ose pa u shpallur, por edhe kur shpallet fituesi, papritmas mbyllet procesi, sepse ka pasur raste kur vetë autoriteti kontraktues e ka mbyllur procesin?

Pyetja tjetër lidhet me problematikat e realizimit të performancës, që, në fakt, ju e përmendet, që është bashkëpunimi i disa institucioneve. Ne kemi ligje shumë të mira dhe unë këtë nuk do rresht së përsërituri, por mënyra sesi ne i zbatojmë dhe sesi operatorë të ndryshëm, individë apo biznese jashtë të gjitha procedurave të mundshme bien dakord apo dakordësohen pikërisht për të prishur procesin apo për të krijuar mungesën e besueshmërisë dhe transparencës është një problem që duhet ta luftojmë të gjithë së bashku. Kemi raste të evidentuara, ku çdo gjë nga ana procedurale duket se ka shkuar normalisht dhe është në linjë me ligjin, por, në fakt, produkti i ofruar apo shërbimi i ofruar nuk është në standardin e kërkuar dhe kjo evidentohet shumë më vonë, ndoshta edhe pasi ka mbaruar sigurimi i kontratës, a do të kenë ndonjë lloj penalizimi për këta operatorë në qoftë se riaplikojnë për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të ngjashme qoftë në nivel fiksimit apo ulje në fiksimit apo mospasje mundësi për të marrë pjesë në tenderët e mëparshëm?

Një problematikë tjetër nga i gjithë raporti që kemi lexuar, edhe si anëtare e Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, janë subjekte të ngjashme ose të njëjtë, të cilët duken rishtazi që fitojnë tenderë nga autoritete të ngjashme ose të njëjtë. Pra, shihet që në një subjekt, i cili rëndon mbi 60-70% të tenderëve, fitohet nga një operator dhe marrëdhënia midis operatorit dhe subjektit kontraktues duket sikur është afatgjatë. Kjo, në syrin tim, ka dy elemente, është ai i rritjes së besueshmërisë dhe njohjes së punës, që është pozitive, por edhe ai i uljes së besueshmërisë për një marrëveshje apo dyshim për një marrëveshje reciproke ndërmjet dy palëve. Ju si autoritet a keni këtu ndonjë mekanizëm monitorimi pikërisht për të garantuar që procesi dhe pjesëmarrja të jenë të barabartë për të gjithë?

Në vijim, kam edhe një element tjetër, personalisht ju kam adresuar një kërkesë, por për hir të komisionit dhe të procesverbalit, dua ta bëj edhe publike pyetjen time. Aktualisht jemi në kushtet, sidomos të pandemisë aktuale, por ka edhe për raste të tjera, kur ne kemi nëpër botë prodhues ekskluzivë të një produkti apo të një shërbimi. Në rast se prodhuesi i këtij produkti apo shërbimi nuk kontraktohet direkt, pra jo nëpërmjet agjencive apo subjekteve të tjera, ndryshimet që ne po kalojmë sot në këtë projektligj a e autorizojnë një subjekt kontraktues që direkt të lidhë marrëveshje me kompani ku prodhohet direkt malli apo shërbimi? Rasti konkret është ai i vaksinës anti-COVID.

Pra, dihet dhe është e qartë se kemi vetëm një kompani, e cila ka ekskluzivitetin e kësaj vaccine apo të një bari tjetër. Dua të di nëse është e mundur që Autoriteti Kontraktues direkt mund të hyjë në marrëveshje nëse vetë kompania ia mundëson një proces të tillë? A e lejon këtë fakt projektligji që ne po kalojmë sot apo do të vazhdojmë sikur kemi vazhduar deri tani, edhe për rastin konkret, ku Kuvendi ka ratifikuar me ligj një marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale dhe Aleat and Gavi për përfitimin dhe për të hyrë direkt marrëveshjen për blerjen e vaksinës?

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Po, zonja Kashta.

Reida Kashta – Faleminderit!

Sa i përket pyetjes së parë, në rast se autoriteti kontraktor nuk e përfundon procesin, pra pyetja besoj se kishte të bënte me kohëzgjatjen e procesit, sepse ende nuk jemi në një lidhje kontrate, po, ka dy momente se kur autoriteti kontraktor kontrollohet dhe monitorohet në rast se e bën një veprim të tillë.

Së pari, ligji përcakton rastet se kur autoriteti kontraktor mund ta anulojë një proces, duke qenë ende në procesin para se të lidhë kontratën. Autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor ta anulojë procesin vetëm nëse ndodhet në një nga kushtet që parashikon ligji. Këto kushte janë të renditura në mënyrë specifike si kushtet që dalin jashtë kontrollit të institucionit, rasti kur operatorët ekonomikë kanë ardhur të gjithë mbi vlerën e fondit limit, si dhe rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur kështu e të tjera. Pra, janë raste konkrete që legjitimojnë një autoritet kontraktor të anulojë një procedurë prokurimi që nuk ka përfunduar ende me lidhje kontrate.

Ka dy mënyra se si kontrollohet sjellja abuzive ose jo e ligjshme. Autoriteti kontraktor në këtë fazë të procesit, së pari, nëpërmjet të drejtës së ankimit, nëse një autoritet kontraktor vendos anulimin e procedurës, nuk mundet që ky anulim të bëhet i vlefshëm pa kaluar koha e pritjes së ankesave. Pra, procesi do të rrijë i ngrirë deri sa të vlerësohet nëse ka apo jo ankesa dhe nëse ka ankesa do të jetë Komisioni i Prokurimit Publik që do të vendosë përfundimisht nëse anulimi bëhet sipas kushteve të parashikuara nga ligji apo anulimi është bërë në mënyrë abuzive.

E dyta, në këtë ligj për herë të parë shtohet edhe kompetenca e APP-së, për të hetuar edhe procedurat e anuluar. Deri tani APP-ja mund të hetonte vetëm procedurat e përfunduara me sukses dhe nëse procesi ka qenë i ligjshëm apo jo dhe mbetjet kështu e zbuluar nëse autoriteti kishte bërë një anulim. Në këtë kontekst për të herë të parë këtu kemi shtuar kompetencën që edhe procedurat e anuluar mund të hetohen nga APP-ja, për të vlerësuar nëse anulimi është bërë i qëllimshëm dhe i paligjshëm apo kemi qenë në kushtet e parashikuara nga ligji.

Për sa i përket pyetjes së dytë në lidhje me standardin dhe cilësinë e një produkti që merret nga një kontratë në përfundim të procesit të prokurimit, më duhet t'ju them se ka dy mekanizma kryesorë që synojnë cilësinë dhe standardin.

E para, nëpërmjet këtij ligji ne nxisim përdorimin e mitit shumë më shumë sesa jemi aktualisht dhe shumë më shumë sesa vetë çmimi më i ulët. Kjo synon në thelb rritjen e cilësisë së produktit, të cilin do të marrim, pra nuk synon automatikisht dhe vetëm çmimin më të ulët, i cili shpeshherë i bashkëngjitet konceptit të cilësisë së dobët, por synojmë të kemi një kombinim midis çmimit dhe cilësisë më të mirë të mundshme për atë çmim që të sigurojmë se nuk po marrim thjesht cilësi të dobët dhe çmim të ulët që do të na bëhet e pavlefshme për një kohë shumë të afërt. Kjo është mënyra e parë se si e nxisim që në proces cilësinë e produktit që duam të marrim.

Së dyti, një rol të rëndësishëm në cilësinë e asaj që marrim e ka autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të kontratës. Për këtë arsye ne po synojmë të nxisim mekanizma monitorues gjatë zbatimit të kontratës, për të siguruar që autoriteti kontraktor nuk është duke bërë në mënyrë qoftë edhe të paligjshme marrëveshje të fshehura me operatorin ekonomik dhe nuk merr cilësinë për të cilën është konkurrar. Autoriteti duhet të sigurohet që gjatë procesit të zbatimit të kontratës të marrë cilësinë për të cilën ka shpallur operatorin ekonomik fitues në një garë, siç është procesi i prokurimit.

Së treti, kemi penalizimin përsëri për operatorin ekonomik në rast se nuk e sjell produktin në parametrat dhe cilësinë e duhur, duke i shkaktuar atij ndërprerjen e kontratës dhe përjashtimin

nga e drejta për të hyrë në procedura prokurimi nga 1 deri në 3 vjet nëse është ndërprerë kontrata, sepse malli nuk është sjellë sipas karakteristikave të dakordësuara. Kjo vlen edhe për periudhën e garancisë, pasi kjo është e lidhur edhe me momentin e planifikimit, sepse autoriteti që në fillim duhet të planifikojë mallin që po merr, çfarë periudhe garancie do t'i kërkojë për t'u siguruar që malli nuk i shfaq defekte menjëherë pasi e ka marrë dhe ka mbaruar marrëdhëniet me operatorin ekonomik.

Për këto arsye, jua theksova që në fillim se procesi është kompleks dhe i ka fillesat e veta te planifikimi dhe i përfundon te ndjekja me rigozitet e zbatimit të kontratës. Më duhet t'ju them se janë tre mekanizma: miti, monitorimi i kontratës dhe ndërprerja e kontratës që sigurojnë cilësinë e mallit për të cilin është lidhur kontrata.

Sa i përket nxitjes së operatorëve ekonomikë ose më saktë nxitjes së shpeshëtisë së marrëdhënies së një autoriteti kontraktor me disa operatorë ekonomikë, dhe jo vetëm një prej tyre, sikurse edhe ju e thatë, kjo ka dy anë të medaljes, atë që konsiderohet qëndrueshmëri në marrëdhënie dhe histori e suksesshme e mëparshme, që lehtëson punën e autoritetit kur bashkëpunon me një operator të caktuar, por ka edhe anën tjetër që mund të ulë numrin e operatorëve aktivë në kontrata publike. Për këtë kemi dy risi në ligj.

E para, për herë të parë, sidomos për kontratat mbi kufijtë monetarë, lotet konsiderohen zgjidhja primare. Pra, nëse nuk e ndan procedurën në lote, duhet të kesh një argumentim, që do të thotë se ndarja në lote synon shumëllojshmëri dhe disa operatorë ekonomikë potencialë që të marrin kontrata edhe brenda një procedure.

E dyta, ne kemi mekanizmin e sistemit të prokurimit elektronik. Pra, për procedura konkurruese askush nuk ndalon dot askënd të ofertojë, kështu që nga pikëpamja ligjore dhe teknike mjedisi në cilin ata ofertojnë është i rregulluar në masën 100%, në sensin që në një procedurë konkurruese askush nuk mund të ndalojë në mënyrë të qëllimshme dhe të paligjshme një operator ekonomik që të ofertojë në një procedurë prokurimi.

Një vëmendje e shtuar do duhet të jetë te negocimi pa shpallje, ku ftesat bëhen direkt nga autoriteti kontraktor, pra nuk mund të hyjë kushdo. Ne këtë procedurë e kemi të cilësuar, prandaj autoriteti kontraktor duhet t'i ndërrojë sa më shpesh operatorët ekonomikë që fton, ndërkohë që kjo është e pamundur për procedurat konkurruese, sepse procedurat konkurruese janë të hapura dhe mund të shkojë kushdo që është i interesuar.

Sa i përket pyetjes së fundit në lidhje me (nuk dëgjohej) përgjigjja është jo, ne nuk kemi një klauzolë të tillë as në ligjin aktual, pasi kjo nuk është në përputhje me direktivën. Ne e kemi diskutuar këtë çështje edhe me ekspertët e SIGMA-s dhe kolegët tanë në vende të Bashkimit Europian dhe direktiva nuk parashikon asnjë klauzolë të tillë që të legjitimojë një autoritet kontraktor të lidhë kontratë me një operator qoftë ai dhe i vetmi, megjithatë kjo zgjidhet me një nga rastet e negocimit pa shpallje.

Një nga rastet kur mund të përdoret procedura e negocimit pa shpallje është kur nga krahu tjetër kemi një operator ekonomik, i cili ka ekskluzivitetin për këtë mall apo për këtë shërbim, pra ai provon që është ekskluziv dhe pastaj legjitimojmë të bëjmë një negociim pa shpallje, por jemi gjithmonë brenda kuadrit të ligjit të prokurimit, ku kemi një procedurë që është negociim pa shpallje. Nuk mund të dalim me një kontraktim të drejtpërdrejtë pa asnjë lloj procesi as me këtë ligj, pasi një parashikim të tillë nuk e ka as direktiva.

Zgjidhjet rast pas rasti, sikurse ishte edhe shembulli që ju sollët për Athinën, do të jenë me marrëveshje që ratifikohen në Kuvend, të cilat për nga hierarkia dalin mbi ligjin e prokurimit dhe nuk kërkojnë detyrimisht zbatimin e ligjit të prokurimit.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja Kashta!

Zoti Gjoni e ka kërkuar fjalën.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Kashta, ju falënderoj për përgjigjet dhe përpjekjet tuaja të papara për t'u dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve të vështira që ju po hasni në këtë komision të nderuar!

Zonja kryetare, besoj se do të më lejosh të bëj një këshillë miqësore dashamirëse, më europiane seç duhet, duke cituar raportet e BE-së. Ne nuk kemi nevojë për raportet e Bashkimit Europian për të kuptuar se në çfarë llumi jetojmë në Shqipëri, për më tepër që raportet hartohen nga njerëz që nuk janë detyrimisht më të aftë sesa ata që punojnë në administratën shqiptare, madje disa prej atyre që punojnë në delegacion këtu apo në Bruksel unë nuk do t'i merrja as për vartësa për të më ndihmuar me *research*. Vetë Bashkimi Europian si entitet është një entitet problematik për sa i përket prokurimit publik, sjell në kujtesë këtu vilën e famshme 1,6 milionë euro në Rolling Hills dhe hetimet që u bënë nga zyra e OLAF-it në Bruksel, që nuk sollën asnjë rezultat pozitiv për të kapur praktikën korruptive të blerjes së kësaj vile, ndërkohë që kishte dyshime të pakundërshtueshme në mënyrën se si u tenderua dhe si u blen një vilë dyfish në krahasim me

çmimin e tregut. Këtë nuk e kam kritikë për ju, por për të thënë që ne nuk kemi nevojë për asnjë raport të jashtëm dhe as për raportin e KLSH-së, që zonja Hyseni me të drejtë e ngriti këtu, për të kuptuar se në çfarë krahure ndodhet prokurimi publik në Shqipëri.

Zonja kryetare, ju keni të drejtë kur thoni se prokurimi publik është realisht një fuçi korrupsioni në këtë vend. Kjo nuk lidhet me ju, zonja Kashta, sepse ju nuk jeni prokurimi publik, ju jeni thjesht një shërbyese civile në administratën shqiptare, e emëruar, mund të rrini atje disa muaj ose vite, mund të çëmëroheni në çdo moment, si t'ia japë truri bajraktarit.

Tani, zonja Kashta, mua më bëri përshtypje një terminologji e përsëritur juaja gjatë të gjithë përgjigjeve që ju dhatë, si ndaj zonjës Hajdari, ashtu ndaj zonjës Mesi, edhe ndaj zonjës Hyseni. Ju përmendët shpesh përgjegjshmërinë e tregut, pra që ju do të nxisni përgjegjshmërinë e tregut shqiptar. Kjo është sikur të presësh që Madona të këndojë Haleluja në kisha evangjeliste. Të flasësh për përgjegjshmëri tregu në Shqipëri, është të vësh duart në kokë. Nuk e kuptoj sesi kura juaj, që ju ofroni ndaj praktikave korruptive në Shqipëri, na qenka nxitja e përgjegjshmërisë së tregut shqiptar. Për cilin treg po flisni, zonja Kashta? A keni dalë ndonjëherë në treg? A keni folur ju ndonjëherë me biznesmenë? Unë nuk kam nevojë për asnjë raport të BE-së për të kuptuar se ku gjendet prokurimi publik në Shqipëri. Mjafton të vini me mua në një udhëtim në rrethinat e Tiranës, të flisni me 10 sipërmarrës dhe biznesmenë, të cilëve kur u përmend prokurimin publik dhe hyrjen në kontratë me shtetin, tmerrohen, jo vetëm për praktikën e mëparshme, që i kanë jashtëzakonisht negative me shtetin, por, gjithashtu, edhe nga perspektiva e hyrjes në një marrëdhënie kontraktuale me shtetin në prokurimin publik, për shkak se ata e dinë shumë mirë që konkurrenca e lirë dhe e ndershme mungon totalisht, nuk ekziston as 1%, jo më 40-50 %.

Tani, ju në këtë projektligj dhe në relacion keni argumentuar se një ndër arsyet pse e keni sjellë këtë projektligj, përveç se t'u afroheni direktivave të famshme të BE-së, dhe standardeve supergjigante ndërkombëtare, të cilat ne do t'i kapim shumë shpejt, mjaftojnë edhe 8 vjet të tjera qeverisë dhe do të jemi shumë afër, por ju flisni për rritje të mekanizmave monitorues të zbatueshmërisë së kontratës. Kuptohet, nuk do shumë mend ose kapacitete për të kuptuar, që kur ju tenderoni një rrugë, kjo rrugë shtrohet me asfalt, por ndërkohë që Shqipëria prodhon botim në Selenicë, bitumi ynë shtron rrugët në Francë, të cilat durojnë 10-20 vjet, ndërsa ne importojmë bitum, shtrojmë fasha asfalti dhe brenda 2 vjetëve ose dhe brenda vitit rruga kthehet me dallgë. Pra, ti jep makinës në rrugët shqiptare dhe të duket vetja sikur je në traqetin e Durrësit-Bari. Nuk ka nevojë të kesh kapacitete për të gjetur se cilët janë operatorët që nuk zbatojnë kontratat,

standardet. Nuk ke nevojë të lexosh fare për standarde europiane për të kuptuar që rrugët, po marr vetëm një aspekt të prokurimit publik, ose çdo aspekt tjetër për të kuptuar se çfarë standardi skandaloz aplikohet këtu nga operatorët, tek të cilët ju keni shpresa kaq të mëdha se do të bëhen të përgjegjshëm, kuptohet në vitin e 8- të të qeverisjes së rilindjes.

Është e qartë që ju nuk keni zbatuar monitorim rigoroz dhe profesional të zbatueshmërisë së kontratës. Është e qartë, ju e pranuat vetë në përgjigjet që dhatë dhe për këtë arsye keni kërkuar që në këtë projekt ligj të parashikohen edhe dispozita për të rritur këta mekanizma kontrollues.

Pyetja ime është shumë e thjeshtë: pse ju keni nevojë për ndryshim legjislacioni për të bërë punën tuaj? Kush ju ka ndaluar ju deri sot që të kontrolloni cilësinë e punimeve dhe efikasitetin e operatorëve? Kush ju ka ndaluar ju për të parë nëse operatorët e zbatojnë kontratën ose e lënë përgjysmë punën? Kush ju ka ndaluar ju që t'i penalizoni këta operatorë për të mos marrë më pjesë në kontrata ose tenderime të mëpasshme? Nuk ju ka penguar legjislacioni. Për këtë nuk mund të na hidhni hi syve. Është e qartë që juve ju ka munguar si infrastruktura, ashtu edhe vullneti për të penalizuar shkelësit.

Ju folët edhe me një terminologji tjetër, që mua më bezdis jashtë mase dhe më kujton një intervistë të famshme të Sali Berishës në “Hard talk”, në viti 2006-2007. Gazetarja britanike i thoshte kryeministrit të atëhershëm se vendi juaj është i korruptuar. Ai i thoshte: “Jo, nuk është korrupsion, është thjesht perceptim korrupsioni. E keni perceptim”. Ju folët për perceptimin korrupsionit në të gjitha përgjigjet që ju dhatë. Mbase e keqkuptova ose nuk kam kapacitetin mendor intelektual ta kuptoj atë terminologji e komplikuar të perceptimit të korrupsionit, por, kur ju flisni për perceptim korrupsioni, në kokën time është sikur këtu nuk paska korrupsion, është thjesht perceptim. Pra, është sikur një trup i mbushur me qeliza kanceroze, por mjeku i thotë pacientit: mos u shqetëso, sepse është thjeshtë perceptim, në radiografi është thjesht perceptim, nuk është kancer.

Zonja Kashta, ju nuk keni kapacitete për të monitoruar zbatueshmërinë e kontratave. Do të ishte më mirë, dhe unë do t'ju respektoja maksimalisht, nëse ju sot do ta pranoni publikisht para nesh, në këtë komision të nderuar, që puna juaj duhet të fokusohet për të forcuar kapacitetet tuaja dhe praktikat tuaja të monitorimit dhe kontrollit të kontratave të punës dhe të cilësisë së operatorëve.

Së fundi, dhe do ta mbyll këtu, zonja kryetare, tani jam në faqen tuaj zonja Kashta, Agjencia e Prokurimit Publik, klikoj te raporte e vlerësime, aty dhe shoh që raporti i fundit i punës suaj është

progresraporti i vitit 2013 i Komision European për Shqipërinë në fushë e prokurimit publik. Shkoj pak më poshtë dhe shoh se Kombet e Bashkuara e rendisin Shqipërinë të dytën në botë për prokurimin elektronik, ky raport është në vitin 2010. Në vitin 2010 unë isha zedhënës i Ministrisë së Jashtme ,Berisha ishte në fuqi në koalicion me LSI-në.

Tani, ju lutem, më thoni, zonja Kashta, ose mbase brouseri i laptopit tim nuk arrin të përditësohet, siç duhet, por si ka mundësi, që kur ju nuk apdejtani për transparencë të paktën raportet e vlerësimit në faqen tuaj ueb, si mundet ju të monitoroni efikasitetin dhe zbatueshmërinë dhe cilësinë e punës? Mos qeshni, ju lutem! Arrogancën e di që e keni në familjen politike, mos buzëqeshni, sepse jeni para një komisioni parlamentar, nëse nuk e keni kuptuar ku jeni. Unë po flas për gjëra që i përkasin fushës publike, nuk po flas për ju personalisht. Unë po ushtroj detyrën time si deputet duke ju kërkuar llogari, pse Agjencia e Prokurimeve Publike, e cila nuk është pronë juaja, zonja Kashta, nuk është pronë e Edi Ramës, Kryeministrit tuaj, nuk është pronë imja, as e Rudina Hjadarit, as e Senida Mesit. Ju jeni atje për të bërë një detyrë dhe funksion publik. Ndaj mos nënqeshni me cinizëm dhe arrogancë, se nuk jua tolerojmë këtu në parlament, por jepni përgjigje pse nuk keni pasur mekanizma kontrolli deri sot? Pse niveli i korrupsionit në prokurimin publik është kaq i lartë? Pse ju nuk keni marrë asnjë masë për të monitoruar zbatueshmërinë e kontratave?

Faleminderit!

Rudina Hjadari – Po, zonja Kashta, fjala është për ju.

Reida Kashta – Faleminderit!

Në lidhje me pyetjen për zbatimin e kontratave, përgjigjja është e lidhur ndoshta edhe me atë që unë thashë pak më parë, që monitorimi i kontratave nuk është një kompetencë e parashikuar nga legjislacioni i prokurimit deri tani që ne po flasim. Pra, për herë të parë kompetenca e monitorimit të kontratave në ligjin e prokurimit vendoset në këtë ligj prokurimi dhe prandaj unë e cilësova që vlerësohet të kemi një kompetencë të shtuar në këtë drejtim për të mbyllur të gjithë ciklin e procesit, me synim rritjen e efikasitetit dhe performancës në procesin e prokurimit. Edhe pse tani e kemi të shtuar këtë kompetencë për monitorimin e zbatimit të kontratave është prapë një detyrë që nuk bëhet e vetme nga Agjencia e Prokurimit Publik, është vendosur dhe parashikuar në mënyrë të atillë që të mos mbivendoset me kompetencat institucioneve të tjera audituese, që kanë rol mbi monitorimin e zbatimit të kontratave. Kjo është përgjigjja sa i përket konceptit ose

parashikimit konkret në monitorimin kontratave. Ky vjen si parashikim i ri ligjor në ligjin e prokurimit, për të synuar rritjen e performancës në sistemin e prokurimit publik.

Sa i përket pyetjes për kompetencat e përjashtimit të operatorëve ekonomikë për shkak të moszbatimit të kontratave në termat ku është prokuruar procesi, përgjigjja është që ne e zbatojmë aktualisht këtë kompetencë, sepse e kemi në ligjin e prokurimit, e kemi pasur që në vitin 2016 në ligjin e prokurimit dhe e zbatojmë aktualisht sa herë përcillet si çështje për hetim nga autoritet kontraktore, të cilat janë palë në zbatimet kontratave dhe ata e vlerësojnë t'i ndërpresin për shkak të moszbatimit të kontratës, sipas kushteve për të cilat janë tenderuar. Ka raste të vendimmarrjeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, të cilat kanë përjashtuar ose vendosur në listën e zezë operatorë ekonomikë që kanë dështuar në zbatimin kontratave sipas termave të prokuruar në një procedurë prokurimi.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Zoti Gjoni, keni ndonjë koment?

Ralf Gjoni – Faleminderit, zonja Kashta, për përgjigjen koncize!

Fakti që nuk ka qenë i parashikuar në ligj, nuk do të thotë që juve t'ju mungojë vullneti, dëshira apo përgjegjshmëria si agjenci për të parë se si zbatohen kontratat. Nuk keni nevojë për parashikime ligjore për këtë. Thjesht nuk ka pasur vullnet më parë për ta inkuadruar këtë nënlegjislacion dhe kjo nuk lidhet vetëm me këtë qeveri, por edhe me ato të mëparshmet, patjetër. Ky është problem kronik i Shqipërisë.

Nuk keni nevojë për legjislacion që ju të tregoheni të përgjegjshëm. Apo duhet të shtojmë edhe një klauzolë tjetër, ku të themi se duhet rritur përgjegjshmëria e punës nga të gjithë punonjësit e Agjencisë së Prokurimit Publik?! Nuk është nevoja të jetë në ligj për të qenë e përgjegjshme, apo jo? Mos duhet të shtojmë në ligj që duhet të jesh në punë në orën 8:00?! Mos duhet të shtojmë në ligj që duhet veshur me rroba kur të vijmë në punë e të mos shkojmë me mbathje?! Janë disa gjëra që janë *common sens*, për të cilat përgjegjshmëria e një agjencie si juaja, nuk ka nevojë për diktat nga ligji për të kryer një funksion aq bazik, siç është monitorimi i kontratave. Megjithatë, ju keni të drejtë. Ligjërisht, për sa kohë që nuk e keni, nuk ju kapim dot!

Ju lutem shumë, miqësisht, caktoni dikë që të shohë faqen tuaj të *web-it*, se është turp, ta marrë vesh Kryeministri Rama që ju ka ngel ora në vitin 2013 apo 2010, koalicioni Berisha-Meta, do t'i ikë petulla! Më fal për folklorizimin e komentit tim, por besoj se më mirëkuptoni në atë që po përpiqem t'ju them! Ose është thjesht një lapsus dhe e keni lënë pas dore, o jeni duke e *update-*

uar faqen tuaj dhe ka ngelur ora në vitet 201-2013, ose realisht të gjitha raportet e vlerësimit nga viti 2013 e deri më sot kanë qenë kaq negative, sa që ju nuk guxon t'i vini në faqen tuaj!

Ju lutem, *update*-oni me raportet e fundit të vlerësimit të punës së agjencisë, me qëllim që edhe publiku, kur të hapë faqen tuaj, të informohet në mënyrë transparente se si vlerësohet veprimtaria juaj.

Ju falënderoj, zonja kryetare!

Reida Kashta – Faleminderit!

Nuk ka lidhje me procesin dhe legjislacionin. Unë jam në këtë institucion që prej vitit 2006, për fatin tim të mirë dhe të keq dhe për historinë time profesionale, kam filluar punë në këtë institucion si specialiste, kam vazhduar si shefe Sektori, kam vijuar si drejtore Juridike dhe më pas si drejtore e Përgjithshme. Jam këtu që prej këtij viti, kështu që nuk ka ndonjë problem nëse aty ka raporte të viteve 2010 apo 2013, sepse unë jam munduar sinqerisht të punoj me to edhe nga pikëpamja profesionale, është një fushë të cilën e dua. Nuk vij këtu vetëm të përfaqësoj institucionin, por kam pasionin tim, për të cilin kam mbaruar edhe doktoraturën në Itali. Megjithatë, kjo është një çështje që lidhet me vullnetin tim personal për të punuar në këtë drejtim.

Sa i përket faqes, këtë më duhet ta verifikoj, ka një lapsus, ose *browser*-i juaj për momentin nuk hap faqen e duhur, por ju siguroj që informacionet janë aty. Ne kemi një sistem prokurimi elektronik, që do të thotë se informacioni ynë në kohë reale është një nga pikat e forta ose një nga çështjet ku ne fokusohemi është nxjerrja e informacionit në kohë reale. Nëse ne bëjmë të gjitha procedurat në kohë reale dhe kemi informacionin aty, nuk ka shanse të mos nxjerrim raportet. Kemi një link, ku flitet për transparencën, e kemi edhe detyrim nga ligji përkatës, që na detyron të nxjerrim çdo raport apo vendimmarrje tonën edhe për autoritetet, edhe për operatorët ekonomikë. Çdo kontroll i bërë nga KLSH-ja, se vitet e fundin janë bërë katër herë kontrolle, ka rezultuar pozitivë në vlerësimin e tyre, me të cilët theksoj se kemi bashkëpunim shumë të mirë, për hir edhe të sistemit.

Pra, patjetër, janë edhe të gjitha analizat tona vjetore, ku ka informacion të detajuar për çdo proces, dhe besoj se të dhënat dhe statistikat që ne nxjerrim çdo vit janë shumë informuese dhe gjithëpërfshirëse për të krijuar një pikturë të plotë të arritjeve dhe problemeve që ka sistemi në makro dhe ato të dhëna që na kanë shërbyer edhe në hartimin e këtij drafligji që kemi sjellë sot për miratim, me të cilin synojmë përmirësim të mëtejshëm.

Theksoj se procesi i prokurimit është një proces dinamik, që çdo herë do të ketë diskutime dhe debate dhe çdo herë do të kemi nevojë për përmirësime të mëtejshme.

Shpresoj shumë që ligji i ri, të cilin jemi munduar ta dakordësojmë me të gjitha palët, përfshirë KLSH-në, palën e biznesit, me të cilin kemi zhvilluar konsultime të drejtpërdrejta, pra jo vetëm komunikime me shkrim, por edhe konsultime të hapura duke bërë dëgjesa me ta, duke u marrë në konsideratë opinionet dhe rekomandimet që kanë dhënë. Shpresoj shumë, edhe për egon time profesionale, por më shumë për të mirën e të gjithëve, që ky ligj të përmirësojë procesin.

Asnjëherë nuk do të dal të bëj ndonjë deklaratë që prokurimin e rregullojmë me një buton dhe e zgjidhim çdo lloj problemi, por është proces dinamik dhe ju siguroj që dëshira jonë, e stafit por edhe e të gjitha palëve të përfshira në këtë grup pune, ka qenë maksimale që ligji të jetë i atillë që të bëhet realisht efektiv në zbatim.

Ne mund ta bënim shumë kollaj duke e kopjuar direktivën, por jemi munduar shumë gjatë dy viteve të bëjmë një ligj që ka vlerë në terrenin shqiptar.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja Kashta!

Zonja Kashta, meqë përmendët grupet e interesit dhe jeni takuar me biznese të ndryshme, cilat kanë qenë kërkesat e tyre dhe si i keni përfshirë në këtë ligj të ri?

Reida Kashta – Ka pasur një sërë kërkesash, për shembull, një parashikim konkret që kishim vendosur ishte që, nëse palët do të kishin probleme gjatë zbatimit, por që nuk saktësohej qartë se nga vinte problemi nga bizneset apo autoritetet, ne ishim treguar pak më të ashpër për të ndërgjegjësuar bizneset, por bizneset patën një reagim për këtë dhe me të drejtë u hoq ndalimi që ne kishim vendosur për palën e biznesit për sa kohë nuk provohet qartazi që problemi vjen nga pala e biznesit.

Një çështje tjetër që ata referuan ishte sistemi i ankimit, shkurtimi i afateve dhe në këtë e bëme duke e bërë procesin njëshkallësh, pra ankimi njëkohësisht do të bëhet edhe në autoritet, dhe twk operatorët ekonomik.

Një pretendim tjetër i tyre është ulja e vlerës së *fee*-së që ata paguajnë kur dorëzojnë një ankesë pranë Komisionit të Prokurimit të Publik dhe në këtë e kemi mbajtur shënim për ta rregulluar në legjislacionin dytësor, duke hapur rrugën në ligj për *fee*-në që do të paguhet nga biznesi në momentin kur ata aplikojnë me një ankesë.

Këto janë çështjet kryesore, të cilat u ngritën nga biznesi që kishin të bënin me facilitimin e pjesëmarrjes në proces, vendosja gjithashtu e ofertimit nëpërmjet vetëdeklarimit, pra në momentin e ofertimit, për të lehtësuar biznesin, ne lejojmë që një sërë dokumentesh të vijnë vetëm në formën e vetëdeklarimit dhe vetëm fituesit i kërkohet lista e dokumenteve konkrete, që duhet t'i ketë para se të lidhë kontratën për të verifikuar nëse janë ose jo në përputhje me deklarinin. Kjo vjen për të lehtësuar procesin e aplikimit nga ana e operatorëve ekonomikë.

Këto janë çështjet kryesore, të cilat mund t'i sjell e t'i ndaj me ju dhe biznesin.

Gjithsesi, i gjithë procesi është i dokumentuar, pra çdo pyetje e bërë jo vetëm nga përfaqësuesit e biznesit, me të cilët bëjmë konsultimin publik, por edhe nga biznese të caktuara, që kanë dhënë komente në faqen tonë, pasi ligji ka qëndruar 4 muaj i publikuar në faqen e agjencisë dhe ka pritur komente nga çdo i interesuar, ndër ta kemi pasur edhe nga biznesi, i kemi të dokumentuara si pyetjet, përgjigjet, marrjen në konsideratë apo kthimin me argumente të komenteve të tyre mbrapsht. Një sërë argumentesh do të mbeten për t'u referuar edhe në legjislacionin dytësor, për të cilin, po ashtu, do të bëjmë të njëjtin proces konsultimi publik sikurse kemi bërë me ligjin.

Rudina Hajdari – Fjala për deputetin Ulqini.

Musa Ulqini – Faleminderit, zonja kryetare!

Shumë shkurt do të bëj tri komente, duke pasur në vëmendje komentet dhe shpjegimet tuajat, sidomos, por edhe të kolegëve të tjerë.

Së pari, mendoj se kjo nismë serioze meriton të gjithë mbështetjen tonë, jo se ne u shprehëm kundër, por, si ligjvënës i vjetër mund ta them këtë, kur mendohet të ndryshohet një ligj, arsyeja e parë është kur ka probleme në fushën përkatëse, vështirësi që vijnë nga shumë arsye dhe mendohet që shumë gjëra mund të rregullohen duke përmirësuar ligjin. Kjo është një gjë, që ndodh rëndom, është një gjë serioze që meriton mbështetje.

E dyta, një arsye për ta përmirësuar, për ta amenduar dhe për ta ndryshuar ligjin përkatës është edhe angazhimi ynë që legjislacionin ta adoptojmë me direktivat e Bashkimit Europian dhe standardet e tij. Janë katër direktiva në këtë projektligj që është sjellë, që u bë përpjekje për t'i adoptuar. Projektligji në thelbin e vet, nga shpjegimet që u dhanë, synon që ta rrisë akoma dhe më shumë transparencën, konkurrueshmërinë dhe monitorimin në një sektor që ka kaq shumë diskutime, probleme, politizime, të pavërteta dhe të vërteta. Këto janë instrumente shumë të rëndësishme, që duhen duartrokitur, që bëhen përpjekje për këto që thashë më sipër. Edhe vetë

procesi nuk ka zgjatur një muaj apo dy muaj, sepse këto janë procese të vështira, ka zgjatur dy vjet, ku kanë qenë të përfshirë jo vetëm ekspertë shqiptarë por edhe ekspertë të BE-së, të SIGMA-s, që janë institucione të specializuara për këtë çështje, është konsultuar edhe me biznesin, të cilët kanë një përgjegjësi shumë të madhe se si bëjnë përpjekjet maksimale për të bërë zbulimet më të fundit shkencore për t'i devijuar proceset kur ato futen në tendera.

Së dyti, kam një falenderim shumë të përveçëm për zonjën Kashta. Kam shumë kënaqësi ta them publikisht, sepse është ndër rastet e rralla, kur i respekton të gjithë kolegët deputetë, pavarësisht se sa ne ishim korrektë me mënyrën se si reaguam për shpjegimet e saj. Në emër të institucionit, në emër të profesionalizmit, si dhe në emër të asaj çka përfaqëson, shpjegimet ishin shumë profesionale, serioze, pa devijuar atë që është themelore, të bëjmë një projektligj sa më të mirë, të mbajë shënim të gjitha vërejtjet nga deputetët dhe nga të gjithë, që ia vlen për ta përmirësuar ligjin.

Unë ju falenderoj personalisht për mënyrën e paraqitjes suaj për një çështje kaq të diskutueshme dhe kaq sensitive nga politika, nga qytetarët, nga biznesi, si dhe nga ndërkombëtarët dhe brovo ju qoftë ju që keni qëndruar heroikisht atje që në vitin 2006, me atë CV që keni, me atë shkollim që keni se jam krejt i bindur se mund të ishit shumë mirë diku tjetër, por unë mendoj që edhe diçka tjetër, që nuk e di se si mund të tingëllojë, por është një qytetari e madhe që të vendosësh që t'i shërbesh vendit tënd duke punuar në institucione të tilla delikate të rëndësishme siç është institucioni ku ju punoni dhe tani keni arritur të jeni edhe drejtuese.

Së fundi, dua t'ju falenderoj për mënyrën se sa profesionalisht reaguat për KLSH-në, por dua të them diçka. Në vitin '92-'97, kur u ngrit për herë të parë KLSH-ja (unë kam qenë deputet i Kuvendit të Shqipërisë), drejtuesi i KLSH-së e përdori atë institucion jo për të monitoruar se si shpërdoroheshin paratë publike, por për të çuar në burg shefin e opozitës së asaj kohe.

Maxhoranca që erdhi në pushtet në '97-ën, aktin e parë që bëri, vendosi një standard shumë demokratik në këtë vend, që institucionin që kontrollon si shpenzohen paratë publike t'ia japë opozitës duke hedhur një hap shumë të madh në konsolidimin e institucioneve demokratike.

Unë vërej me keqardhje që vitet e fundit kjo traditë, ky hap i mirë, nuk është respektuar nga ata që e kanë drejtuar KLSH-në, sepse ka pasur një politizim të tejskajshëm në shumë raste dhe kjo bën që shifrat e KLSH-së, që flasin për miliarda lekë të çuara dëm, ndaj saj nuk reagon askush seriozisht, nuk reagon as prokuroria, as media, as BE-ja dhe askush.

Jam i bindur që ekipi i ri, kryetari i ri i KLSH-së, do të bëjë përpjekje maksimale për ta rregulluar imazhin e këtij institucioni në mënyrë që ky institucion të bëjë atë rol që ka, të monitorojë nga afër të gjitha institucionet e shtetit se si shpenzojnë paratë publike.

Në fund fare, dua të them që është një hap i mirë, është një hap në drejtimin e duhur dhe është një hap që bën përpjekje që ky institucion të jetë edhe më i monitorueshëm, edhe më transparent, jo vetëm për ndërkombëtarët, jo vetëm për bizneset që kanë interesë, jo vetëm për partitë politike, por edhe për median dhe për shqiptarët.

Kështu që unë, zonja kryetare e komisionit, i ndoqa me shumë vemendje shqetësimet tuaja që duken shumë të drejta dhe ju falenderoj, të paktën në emrin tim, them që është një projekt shumë serioz, nga më seriozët që kemi diskutuar në komisionin tonë.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Ulqini!

Unë doja t'i bëja disa pyetje zonjës Kashta në lidhje me raportin që ka bërë Komisioni European dhe arsyeja pse e bëj këtë është që, duke qenë se jemi në Komisionin e Integritit dhe duke qenë se na intereson që ne të ecim në këtë proces dhe detyra jonë kryesore në këtë komision është pikërisht përmirësimi i këtyre raporteve.

Në rolin e opozitës dhe të kryetares së Komisionit të Integritit është detyra ime për t'i vënë dukje të gjitha problematikat që shfaqen në raportet e Komisionit European, por unë kam edhe një pekt tjetër, jam edhe deputete dhe ligjvënëse dhe më kërkohet që të kërkoj llogari për mënyrën se si përdoren paratë publike.

Për të dyja këto aspekte, mendoj se është shumë e rëndësishme që ta përdorim këtë rast për ta pyetur zonjën Kashta se si ky ligj i ri do ta përmirësojë kuadrin ligjor dhe do ta përmirësojë situatën si brenda në Shqipëri, por edhe në raport me procesin e integritit.

Ajo që vuri në dukje zoti Gjoni, me të drejtë, është fakti që ligji ekzistues nuk ka krijuar kaq vështirësi në mënyrën se si ju e keni zbatuar ligjin dhe për ta sjellë këtë në dukje, edhe nga raporti i fundit i Komisionit European, thuhet se në regjistrin e koncesioneve, që përmban informacion për mbi 224 PPP, pesë prej të cilave janë nënshkruar gjatë vitit 2019, thuhet këtu, megjithëse kërkohet nga ligji (pra nga ligji i 2019-s, jo ky i riu), analiza e vlerës që është bërë për paratë nuk kryhet në mënyrë sistematike para miratimit të të gjithë PPP-ve, pra ka një lloj abuzimi në mënyrën e ofertave dhe fryrjes së çmimeve.

Si ka mundësi, që edhe pse ligji e kërkon, analiza e vlerës nuk bëhet nga autoriteti ligjvënës, në mënyrë që ju të zbatoni ligjin ekistues ashtu siç është dhe duke qenë se keni një eksperiencë shumë të gjatë, dhe unë e vlerësoj faktin që ju keni një ekepsperiencë shumë të gjatë, por ideja është që ne jemi këtu si ligjvënës dhe, nëse do të flasim si ligjvënës, mua më intereson mënyra se si përdoren paratë publike dhe se si zbatohet ligji.

Nëse keni një përgjigje në lidhje me këtë, do ta vlerësoja.

Kashta - Faleminderit!

Përveç asaj pjese që ju lexuat në raport, e cila i referohet kapitullit V, kapitulli V ka të përmbledhur prokurimin publik, koncesionin, PPP-të, prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, pra ka tri shtyllat kryesore, të cilat janë të përmbledhura në këtë kapitull. Pjesa që ju lexuat i referohet ligjit të koncesioneve nr.125/2013, i ndryshuar, pra nuk i referohet legjislacionit të prokurimit dhe çështjes që po diskutojmë sot dhe nuk kam kompetencë të komentoj mbi atë ligj aktualisht. Pra, unë mund të marr informacion si kryesuese e kapitullit, nëse ju kërkon një informacion mbi çështjen, por ajo pjesë e komentuar, e deklaruar dhe e shtjelluar nga progresraporti në këtë rast i referohet legjislacionit koncesioneve dhe PPP-së për të cilin është përgjegjës, të gjithë bashkë jemi, por institucioni kryesor kompetent është Ministria e Financave dhe ATRAKO-ja, pra nuk i referohet konkretisht ligjit të prokurimit dhe nuk kam një përgjigje për të thënë se si do ta rregullojë ky projektligj, të cilin kemi sjellë sot, këtë problematikë të nxjerrë nga progresraporti, sepse nuk bën një rregullim në koncesione dhe PPP.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Sipas opinionit të zotit Kasneci, shikoj se nuk keni rënë dakord për tri pika, pikën 5, pikën 7 dhe pikën 20.

Mund të më thoni pse nuk keni rënë dakord me këto pika?

Kashta - Faleminderit!

Një nga rastet ku nuk kemi rënë dakord është në nenin 44, pika 7, paragrafi i dytë, dhe pika 8.

Nga zoti Kasneci është referuar që ne të shtojmë, po citoj: “procedura konkurruese me negociim mund të zhvillohen në faza të njëpasnjëshme për të ulur numrin e ofertave që do të negocohen, bazuar në kriteret e përzgjedhjes, të specifikuar në njoftimin e kontratës në ftesën për shprehje interesi ose në një dokument tjetër të tenderit”.

Ajo me të cilën ne nuk biem dakord është shprehja “ose në një dokument tjetër të tenderit”, duke qenë se vlerësojmë kopjimin fjalë për fjalë të nenit të direktivës në këtë pikë si mundësi diskutimi, konfuzioni për të dy palët.

Nëse ne do t’i jepnim mundësi Autoritetit Kontraktor me një shprehje të tillë “ose në një dokument tjetër të tenderit”, AK-ja mund të ndodhë ta keqpërdorë, duke fshehur informacionin që duhet të bëjë publik në ndonjë dokument të paspecifikuar.

Ne synojmë që kriteret e përzgjedhjes të jenë të specifikuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi. Pra, duhet të themi specifikisht se ku autoriteti do të ketë detyrimin ta vendosë kriterin dhe po shtuam shprehjen “ose në një dokument tjetër të tenderit” mund të lëmë mundësinë që autoritetet të na e keqpërdorë këtë mënyrë të shkruari duke e vendosur, po themi, kriterin te grafiku i punimeve dhe të thotë ligjërisht që, po, unë e kam vendosur një dokument tjetër se ligji ma lejon, por kjo gjëja nuk do t’i japë mundësi operatorëve të njihen drejtpërdrejt me të, sepse do të jenë të konfuzuar dhe nuk do të dinë se ku do të gjejnë të dhënat që kërkohen.

Duke qenë se kemi të bëjmë me kriteret përzgjedhjeje, që janë shumë të rëndësishme për t’u ditur nga pala tjetër, kemi sugjeruar që të jemi konkret në ligj, duke thënë se ku ky informacion duhet të vendoset nga AK-ja dhe duhet ta kenë të qartë të gjitha palët, se, nëse unë si operator do të lexoj “ose në një dokument tjetër të tenderit”, i bie që të hap të gjithë dokumentet me radhë dhe të gjej se ku e ka fshehur autoriteti këtë lloj informacioni.

Ky është këndvështrimi ynë, që nuk bie dakord për shprehjen “ose në një dokument tjetër të tenderit”, se na duket i hapur.

Një çështje tjetër për diskutim është te neni 46, pika 1, paragrafi 4 dhe pastaj pika 5 dhe 8.

Ajo për të cilën ne nuk biem dakord është shtimi i një shprehjeje, po citoj: “Në dokumentet e tenderit përcaktohen kërkesat minimale që duhet të plotësojnë të gjitha ofertat. Informacioni i dhënë duhet të jetë mjaft i saktë që të mundësojë operatorët të identifikojnë natyrën dhe objektin e zgjidhjes”. Shprehja “mjaft i saktë” është përsëri shprehje e hapur në vlerësimin tonë dhe kjo është një nga sfidat që ne kemi pasur me të gjithë shprehjet e kësaj natyre në direktivë. Ne vlerësojmë se duhet të jemi konkretë kur shprehem, pra informacioni duhet t’u mësojmë operatorëve ta identifikojnë. Nuk ka nevojë të themi: mjaft i saktë. Në fakt, shprehja në anglisht është *sufficiently precised*, që do të thotë: mjaftueshmërisht i përcaktuar. Në vlerësimin tonë kjo është një shprehje e hapur, dhe do të mbetet në subjektivitetin e çdo autoriteti për të vendosur se çfarë konsiderohet mjaftueshmërisht e përcaktuar.

Ne vlerësojmë se duhet të jemi konkretë, që të mos lëmë hapësirë për subjektivitet nga ana e autoriteteve kontraktore, që mund të na shkaktonte dhe praktika të ndryshme nga njëri autoritet te tjetri. Pra, njëri nxjerr një lloj informacioni, tjetri nxjerr një lloj tjetër informacioni, se kështu përkthehet shprehja: mjaftueshmërisht i saktë.

Ne jemi munduar të gjitha këto lloj shprehjesh nga nenet e ligjit, për të qenë sa më konkretë, që t'ua themi qartë autoriteteve e operatorëve, se cilat janë të drejtat, detyrimet apo kërkesat në një proces. Kjo ishte çështja e dytë.

Çështja e tretë, e ngritur nga zoti Kasneci, i referohet nenit 127 të projektligjit. Zoti Kasneci na ka sjellë në vëmendje se referenca jonë te shtesat e kontratës ka të bëjë me amendimet e kontratës pa procedurë, pra një kontratë ekzistuese. Preferenca jonë është në vlerën 20 %, ndërkohë që zoti Kasneci i referohet një pike tjetër të direktivës.

Do të mundohem të jem e qartë, sepse mund të shkaktohet pak konfuzion. Direktiva parashikon mundësinë e amendimit të kontratës pa procedurë. Ka dy kategori: amendim kontrate deri në 50 % të vlerës fillestare, në rast se plotësohen disa kushte, dhe listohen kushtet: 1, 2, 3, 4, 5; amendim të kontratës në vlerën 10 % për kontrata shërbimesh dhe 15 % për mallra ose punë, pa kushte fare, mjafton që këto të jenë në një kufi të caktuar monetar.

Për kontrata deri në 80 milionë lekë, po e them unë 80 milionë, sepse nuk është fiks kjo shumë, sipas direktivës autoritetet kontraktore lejohen të bëjnë shtesa, pavarësisht nëse plotësojnë apo jo një kusht, deri në vlerat 10 % - 15 %. Për kontrata mbi kufirin 80 milionë lekë, mund të bëjnë shtesa deri në 50 %, nëse plotësohet një nga kushtet. Këtë thotë direktiva.

Në transpozim, ne e konsideruam këtë si mundësi shumë të hapur, jo të gatshëm për ta përdorur brenda vendit, sepse mund të sjellë abuzim në zbatim. Kjo do të thotë se unë lidh një kontratë, dhe kam mundësi që 50 % të asaj vlere ta amendoj pa bërë asnjë lloj procedure prokurimi. Kësisoj, vlerësuam të sjellim në legjislacionin aktual, në fazën ku ndodhemi – mbase do ta bëjmë 100 % kur të bëhemi anëtarë të BE-së, apo pak më vonë – pra në fazën ku ndodhemi vlerësojmë se duhet të lejojmë amendimin vetëm deri në 20 % të vlerës së kontratës, jo 50 %, vetëm nëse plotësohen disa kushte. Pra, duhet të plotësohen disa kushte, që autoriteti të legjitimohet për të amenduar një kontratë deri në 20 %, jo 50 %, sa e ka direktiva. Alternativën 10 dhe 15, që ka sjellë zoti Kasneci këtu, e që direktiva e ka pa asnjë lloj kushti, ne nuk e kemi parashikuar fare. Pra, nuk lejojmë amendime kontrate, nëse nuk ka një sërë kushtesh, sepse e shohim si një mundësi për keqpërdorim nga ana e autoriteteve kontraktore, që për vlera të caktuara, të cilat do të jenë

relativisht të vogla, të bëjnë afrofë, pra automatikisht 10 % shtesë kontrate, meqenëse ligji do t'ua lejonte.

Ne vlerësojmë se duhet t'i rrimë këtij lloj parashikimi. Shtesat e kontratës të bëhen vetëm deri në 20 %. Pavarësisht se ekspertët e kanë gjetur jo në përputhje, sepse na thonë se direktiva është 50 %, ne nuk vlerësojmë se duhet të jemi te 50-përqindëshi. Duhet të jetë 29 %, dhe vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligj.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Po, zoti Kasneci, fjala për ju!

Hapeni mikrofonin, ju lutem!

Dedë Kasneci – Dëgjohem tani?

Rudina Hajdari – Po.

Dedë Kasneci – Atëherë, i marrim me radhë të tria pikat, për të cilat Agjencia e Prokurimit Publik, zonja Kashta, ka paraqitur komentet e saj.

Lidhur me pikën e parë, ku ne kishim sugjeruar që procedurat konkurruese me negociim, siç u lexua, mund të zhvillohen në faza të njëpasnjëshme për të ulur numrin e ofertave që do të negociohen, bazuar në kriteret e përzgjedhjes, të specifikuar në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose në një dokument tjetër të tenderit.

Në fakt, zonja kryetare, nuk është se ne bëjmë shpikje. Ne i referohemi legjislacionit të BE-së. Jemi në procesin e integritetit, dhe ata, të zotët e punës, kështu e kanë menduar. Edhe direktiva i parashikon të tre llojet e dokumenteve, se si duhet të jetë. Pika 6 e nenit përkatës të direktivës, thotë: në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, ose në një dokument tjetër të prokurimit. Pra, ne i kemi marrë të tria këto kategori.

Në fakt, pjesërisht ajo që thotë zonja Kashta qëndron, që mund të jetë bazë për abuzime, por dokumentet e tenderëve janë dokumente zyrtare. Qëndron 100 % argumenti, duke qenë se ka direktiva të BE-së, në procesin e përafrimit. Pra, direktiva parashikon tri kategori. Pas shqyrtimit, ne kemi sugjeruar që kjo të përfshihet. Gjithsesi, e vendosni ju, e nderuara zonja kryetare!

Pra, le të themi se ky është një pranim i pjesshëm i sugjerimit tonë në lidhje me këtë pikë. Ne i qëndrojmë sugjerimit tonë, që kjo pikë të parashikohet. Sepse dokumenti i tenderit, siç e thotë vetë akti, nga faqja e parë deri tek e fundit, nga 'A'-ja tek 'ZH'-ja, është dokument zyrtar, ndaj nuk besoj se mund të lindin probleme ose abuzime nga autoritetet kontraktore apo nga subjektet.

Pra, ne i qëndrojmë sugjerimit tonë, zonja kryetare, në linjë me parashikimet e direktivës.

Reida Kashta – A mund të bëj një koment të fundit, ju lutem?

Rudina Hajdari – Një sekondë, ju lutem, para se ta merrni fjalën.

Zoti Kasneci, më dëgjoni?

Dedë Kasneci – Po.

Rudina Hajdari – Sa i përket pikës 20, a kishit ndonjë gjë tjetër në lidhje me të? Sepse përmendët vetëm pikën 6, mënyrën se si arsyetoni, si dhe pikën 7, që ishte mënyra si është vendosur. Në lidhje me pikën e fundit, a kishit ndonjë koment?

Dedë Kasneci – Pikën e fundit, zonja kryetare, ne e konsiderojmë shumë thelbësore. Dua ta them qartë, shkurt: 50-përqindëshi që përmend zonja Kashta, është kriter që lidhet vetëm me çmimet. Pra, në tabelën e përputhshmërisë, që është sjellë nga qeveria, thuhet se neni 127, pika 2, ka përafshuar nenin 72, pika 2 të direktivës së BE-së, nën tek i cili direktiva e BE-së vendos dy kritere. Kriteri i parë janë kufijtë monetarë, që duhet të respektohen. Kriteri i dytë, nuk duhet të shkojë më lart se 10 % e vlerës së kontratës fillestare të përshkallëzuar, kontratat e shërbimit e të furnizimit, dhe 15 % të vlerës fillestare të kontratave për punë. Pra, ligji e thotë 20%.

Ka mundësi edhe të jetë bërë ndonjë ngatërresë gjatë hartimit të tabelave. Atëherë i bie që ky kufizim që parashikon direktiva, deri në 10 % e 15 %, nuk është i përafshuar, gjë që do të thotë se, nëse nuk do të parashikohet, operatorët ekonomikë mund ta rishikojnë edhe deri në 100 % kontratën fillestare, pa një procedurë tenderimi.

Prandaj, është e rëndësishme që në këtë pikë të thuhet se përse nuk është përafshuar dhe kjo të jetë në argumentet. 50-përqindësi lidhet vetëm me çmimet, zonja kryetare! Kjo është e përcaktuar në pikën e parë të nenit përkatës 72, pika 1 të direktivës, si dhe në pikën e parë të nenit 127. Formulimi i pikës 127, pika 2 është identik me atë të direktivës. Pra, thuhet: “vlera totale e kontratës”, ndërsa 50-përqindëshi është vetëm për çmimin.

Pra, në vlerësimin tonë, ky është një element thelbësor, zonja kryetare! Nëse nuk përafrohet kufizimi ose 20 %, ose 15 %, sepse direktiva e ka të përshkallëzuar, në vlerësimin tonë ky është element thelbësor, dhe është shumë më i rëndësishëm se 50-përqindëshi i çmimit. Mund të parashikohet deri në 20 % çmimi, por vlera totale e kontratës nuk mund të kalojë, siç e ka edhe direktiva: 10 % për kontratat e shërbimit e furnizimit, dhe 15 % për kontratat e punës. Pra, ne i qëndrojmë kësaj zonja kryetare, sepse është në linjë me direktivën. Edhe në tabelë është thënë se është përafshuar pjesërisht.

Rudina Hajdari – Zonja Kashta, keni ndonjë përgjigje në lidhje me këto?

Reida Kashta – Po. Në lidhje me çështjen e parë, mbi shprehjen “ose një dokument tjetër të tenderit”, doja të theksoja se edhe njoftimi i kontratës, siç është një fjalë përpara dokumentit, kur ne themi: “kriteret duhet të jenë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi”, të dyja këto janë pjesë e dokumenteve të tenderit. Pra, shprehja: “ose në një dokument tjetër të tenderit” është shprehje e shtuar dhe vendoset në një kontekst direktive që rregullon marrëdhëniet midis shteteve anëtare dhe u vë atyre detyrimin që ta vendosin konkretisht në ligjin e tyre se si duan ta shprehin.

Pra, direktiva në makro thotë: vendose ku të duash në paketën e dokumenteve të tenderit. Por në një ligj konkret si ky që kemi ne, dhe aktualisht në një vend që s’është ende anëtar, duke pasur parasysh edhe kontekstin se çfarë duam të rregullojmë, ne duhet të shprehim konkretisht se ku do të jetë informacioni, sepse mund të shkaktojmë konfuzion tek palët, tek të dyja palët, por sidomos tek operatorët ekonomikë. Këtë duam të shmangim. Heqja e kësaj shprehjeje, edhe nga konsultimet që kemi pasur me përfaqësuesit e delegacionit Europian apo të SIGMA-s, nuk është gjetur në kundërshtim me direktivën, sepse nuk e humbet qëllimin e nenit, por është thjesht vendi se ku do të vendoset informacioni. Kjo thjesht do të na lërë një hapësirë për konfuzion e për subjektivitet nga ana e autoritetit në të ardhmen.

Vendimmarrja është e juaja, por unë vlerësoj se shprehja “ose dokument tjetër” duhet të hiqet, duke qenë se është shprehje e hapur. Edhe njoftimi i kontratës, në vetvete është dokument tenderi.

Sa i përket çështjes së fundit, që trajtoi zoti Kasneci, është lapsus referimi në tabelat e përputhshmërisë. Ne nuk kemi përafuar 72/ 2-shin, por 72-1-shin. Përmbajtja e nenit është motamo sipas 72/1-shit të direktivës dhe i referohet amendimit të kontratave, nëse kemi plotësim të disa kushteve. Kur flasim për 20 %, 15 % apo 50 %, janë gjithmonë në referencë të vlerës. Pra, gjithmonë është fjala për referencë të vlerës totale. Është 50 % e kontratës bazë, është 15 % e kontratës bazë, është 20 % e kontratës bazë.

Ajo që kemi menduar me grupin e punës, e që dua të theksoj këtu, është që hapja e së drejtës për amendim kontrate deri në 50 %, është shumë e madhe dhe lë vend për subjektivizëm. Vendosja e parashikimit, sipas 72/2-shit, që të kemi 15 % ose 10 % respektivisht të drejtë amendimi pa asnjë lloj kushti është një mundësi shumë e madhe për abuzimin në zbatimin në praktikë. Ne vlerësojmë që në këtë pikë nuk duhet të jemi 100% të përafuar, por e dimë që jemi pjesërisht të përafuar.

Pika 2, pra 72/2 nuk duhet të silltet ende në legjislacionin shqiptar dhe absolutisht që nuk lexohet si mundësi për 100% të kontratave. Ju lutem, të mos e bëjmë këtë diskutim, sepse kthehemi në një lexim në të kundërt. Nëse ne nuk themi që kjo gjë lejohet, pra nëse nuk japim një mundësi, do të thotë që absolutisht në këto kushte nuk lejohet amendimi i kontratës. Me këtë ligj synojmë të lejojmë amendimin me vlerë vetëm nëse plotësohen një sërë rrethanash, që të mos e kthejmë në abuzim këtë lloj procesi.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Meqenëse pika 20 ishte një çështje thelbësore, zoti Kasneci, a keni një përgjigje për sa tha zonja Kashta në lidhje me këtë pikë? Vazhdoni t'i qëndroni mendimit tuaj? Ishte lapsus apo jo, sepse nuk po kuptohet?

Dedë Kasneci – Zonja kryetare, në vlerësimin tonë, sillen dokumentet nga qeveria: projektligji, tabela e përputhshmërisë dhe relacioni. Shërbimi ynë i analizon fjalë për fjalë, pikë për pikë dhe presje për presje. Nuk është lapsus. Përmbajtja e pikës 2 të nenit 127 është sipas pikës 2 të nenit 72 të direktivës. Nuk duhet të ngatërrojmë 50% që thotë zonja Kashta është një nga kushtet... *(nuk dëgjohet.)* mund të jetë më shumë se 50%. Nuk bëhet fjalë për vlerë totale të kontratës.

Zonja Kashta ta thotë qartë: “Nuk duam ta për afrojmë, nuk kemi mundësi”. Është në kundërshtim me direktivën. Direktiva ka një kufi dhe argumenti që është dhënë është për të shmangur abuzimet. Vetëm për çmimin, jo të gjitha kriteret, por vlera totale e kontratës është gjë tjetër. Vlera totale e kontratës nuk mund të jetë në ato kufij që ka direktiva. Për momentin në ligj nuk ka kufizime, e ka 20%. Në rastin e parë është 10% më lart, në rastin e dytë është 5% më lart sesa e ka direktiva.

Pikën 2 të nenit 72 të direktivës të na thotë zonja Kashta se ku e ka të për afrojuar? I bie që nuk është për afrojuar. Shqipëria ka detyrim ditën e aderimit që të gjithë legjislacionin ta ketë të për afrojuar dhe të zbatueshëm. Gjatë rrugës pastaj duhet ta për afrojë.

Në kolonën të tabelës jepen argumente pse nuk është bërë për afroimi, por jo se referenca që është dhënë aty nuk i referohet. Përmbajtja e pikës 2 është në nenin përkatës të direktivës që e kufizon në mënyrë të për shkallëzuar në 10% dhe 15% vlerën totale të kontratës dhe të marrëveshjes kuadër.

Rudina Hajdari – Po, zonja Kashta.

Reida Kashta – Nuk e di nëse mund ta them. Po, unë e saktësova që pikën 2 nuk po e përfaqësojmë tani, duke dhënë argumentin pse mendojmë që nuk duhet të përfaqësohet në këtë moment, megjithatë mbetet në vlerësimin tuaj. Pra, përfaqësimi i këtij neni është i pjesshëm me vetëdijen për të shmangur abuzimin. Ndërkohë që lapsusi është në tabelën e përputhshmërisë, referenca. Megjithatë, mbetet në vlerësimin tuaj.

Dedë Kasneci – Zonja Kashta, një pyetje: qëllimi i direktivës është të shmangët abuzimi,, duke vënë kufij, nëse ato kufij nuk i vendos, autoriteti kontraktor deri ku mund të shkojë, kur nuk ka kufizime?

Reida Kashta – Nuk e bën dot fare. Nuk ka mundësi mendimi. Nëse ka një nevojë ekstra, do të duhet ta prokurorë nga e para me procedurë të hapur.

Dedë Kasneci – Unë kam shumë respekt për ju, për CV-në tuaj, por një gjë që nuk e ndalon ligji, e lejon...(nuk dëgjohet.)

Reida Kashta – Atëherë, mund të shtojmë një fjali: “Nuk lejohet amendimi”, por kjo nuk do të thotë se ne do ta përfaqësojmë direktivën në këtë pikë.

Dedë Kasneci – Po, e vëmë këtë dhe je në përputhje të plotë me direktivën. Bravo të qoftë, je në pararojë me të gjitha vendet e BE-së! Jam shumë dakord me këtë gjë.

Reida Kashta – Nuk e vlerësoj kështu. Megjithatë, mbetet në qëndrimin tuaj. Logjikisht jemi në të njëjtën linjë. Po themi se nuk duhet të lejohet amendimi i kontratës në këtë fazë. Po, nuk jemi në përputhje me direktivën 100% në këtë nen, sepse nuk vlerësojmë se jemi në këto kushte. Sigurisht, kur të bëhemi vend anëtar, të jemi përmirësuar pak më tej në të gjithë sistemin, atëherë mund të shkojmë në përfaqësim të plotë, përndryshe, i bie që do të kopjonim direktivën.

Sjell në vëmendje se direktiva është rregull është ligj që rregullon marrëdhëniet midis shteteve dhe mbi një kufi të caktuar monetar. Direktiva nën një kufi të caktuar monetarë i lë shtetet anëtare të veprojnë sipas vlerësimeve të tyre, duke u ruajtur parimet. Megjithatë, është e pamundur që ne ta përkthejmë *mot a mot* një direktivë që rregullon marrëdhëniet midis shteteve, pra ta bëjmë ligj të brendshëm në Shqipëri. Ky është vlerësimi ynë. Vlerësimi përfundimtar ju mbetet juve, por nuk është në përputhje me direktivën 100%.

Dedë Kasneci – Zonja Kashta, tavanet në direktivë janë detyruese për shtetet anëtare të BE-së dhe, bazuar te neni 70, edhe për ne në procesin e aderimit. Ju duhet të jepni argumente, por, duke qenë se themi 20%, cili është problemi ta ulni në 15, 10%, siç e ka direktiva?

Reida Kashta – Po, sepse nuk po flasim për të njëjtat nene. Ne mund ta ulim, por po flasim për pika të ndryshme të nenit 72. Atë që e kemi 20%, direktiva e ka 50%. Për çmimin flasim edhe ne.

Dedë Kasneci – Nuk e lejon 50% direktiva vlerën totale të kontratës.

Reida Kashta – Po, në mënyrë kategorike.

Dedë Kasneci – Jo vetëm te çmimi.

Reida Kashta – Unë nuk besoj se ia vlen të bëjmë këtë debat këtu. Unë kam 2 vjet që punoj me ligjin dhe direktivën, por patjetër që 50 % i direktivës i referohet vlerës.

Dedë Kasneci – Jo, jo, ja se si e thotë direktiva: “ Është rritja në çmim”, kurse 15% dhe 10% është leja fillestare e kontratës, kurse 50% është çmimi. Pra, janë gjëra krejt të tjera. Ju thoni që nuk mund ta përafroni. Ne i qëndrojmë sugjerimit tonë në linjë me parashikimet e direktivës.

Reida Kashta – Rritja e çmimit 50% është automatikisht rritje e vlerës së kontratës, megjithatë nuk kam koment tjetër përveçse të them: po, nuk jemi në përputhje 100%, por e kemi vlerësuar kështu. Po flasim për përqindje të vlerave monetare.

Ralf Gjoni – Zonja kryetare, ju lutem për procedurë!

Rudina Hajdari – Arsyeja pse po e lejoj debatin midis zotit Kasneci dhe zonjës Kashta është se pika, që i referohet zoti Kasneci, është një pikë thelbësore. Është një mënyrë për të abuzuar me këtë ligj dhe autoriteti kontraktues, nëse po e bën këtë gjë, po e bën në mënyrë të hapur që ta lejojë abuzimin. Prandaj është shumë e rëndësishme që ne të jemi të qartë me direktivën e BE-së, pra mënyra sesi është dhe mënyrën se si po e aplikojmë ne.

Zonja Kashta në këtë rast thotë se janë dy gjëra të ndryshme. Seriozisht dhe sinqerisht mendoj se duhet ta respektojmë njëri tjetrin, sepse është shumë e rëndësishme, pasi jemi duke folur për një projekt ligj, i cili prek paratë publike, paratë e taksapaguesve shqiptarë dhe, normalisht, duhet të jemi shumë seriozë në lidhje me këtë pikë. Duke marrë parasysh dhe peshën që ka kjo temë sot, kjo çështje në Shqipëri dhe, siç e tha edhe zoti Gjoni, një fuçi e madhe korrupsioni ndodh pikërisht në prokurimet publike, është një nga çështjet kryesore që, sa herë shkoj në vendet anëtare të BE-së, sidomos në vendet skeptike, ngrihet shpesh si temë. Prandaj, zoti Kasneci, por për sa u përket përkufizimeve nuk është një çështje që më shqetëson, por në lidhje me pikën 20 është një gjë që mendoj se me durimin e kolegëve, dhe ju kërkoi ndjesë nëse kam marrë më tepër kohë sesa ishte parashikuar, kjo pikë është e rëndësishme dhe po u jap mundësinë që të debatojnë me njëri-tjetrin.

Zonja Mesi ka kërkuar fjalën, si dhe zoti Gjoni. Ju lutem, shkurtimisht!

Senida Mesi – Zonja kryetare, ju falënderoj për fjalën!

Fjalën e mora për dy arsye. E para, për procedurë. Palët mund të debatojnë sa të duan, e rëndësishëm është që ne të kemi një raport të shkruar nga Drejtoria për Përafrimin e Legjislacionit me BE-në. Besoj se anëtarët e komisionit e kanë lexuar. Dëgjuam argumentet dhe kundër argumentet e të dyja palëve dhe, për procedurë, na takon të kalojmë për votim.

E dyta, nëse ka paqartësi nga kolegët deputetë në lidhje me kuptueshmërinë e këtij neni apo e kësaj kërke, janë të lutur të pyesin përsëri si zotin Kasneci, ashtu dhe zonjën Kashta në lidhje me këto paqartësi për sa i përket kësaj reference.

Në kuptueshmërinë time, dhe nga sa kam lexuar nga raportet dhe nga argumenti i zonjës Kashta, legjislacioni dhe direktiva e BE-së është më e hapur, më transparente. Ne duam të jemi më konservatorë në Shqipëri, pasi nuk jemi gati. Zonja Kashta e pranoi këtë gjë dhe tha: “Nuk jemi gati ende” që të shkojmë me një procedurë që të lejojmë deri në një përqindje të caktuar për ndryshimin qoftë të çmimit, qoftë të kontratës. Pra, kemi ulur kufirin e njëres, ndërsa tjetrin nuk e kemi pranuar fare.

E treta, por jo më pak e rëndësishme, ne nuk kemi sot detyrim të transpozojmë, të kopjojmë 100% të direktivave. Besoj se këtu kemi kuptueshmërinë e të gjithëve. Jemi të detyruar që gjatë rrugës për anëtarësim të shkojmë aty ku duhet. Sot kemi avancuar me hapa shumë të rëndësishëm në lidhje me përmirësimin e këtij legjislacioni dhe askush nuk na pengon nesër të jemi propozues të ndryshimit të ligjeve. Pra, autoriteti përkatës, një grup deputetësh, Këshilli i Ministrave mund të propozoj ndryshime të mëtejshme në momentin kur vetë Agjencia për Prokurimin Publik është e gatshme të pranojë sfidat e tjera në lidhje me ndryshimet apo avancimin, le të themi, drejt transpozimit apo adaptimit 100% të direktivës së BE-së. Na takon neve si anëtarë të këtij komisioni ta kalojmë për votim për pranimin apo jo të këtij argumenti.

Ndërkohë, zonja Kashta, nëse krijohet një lapsus, ju duhet ta lexoni edhe një herë nenin përkatës në shqip, pra që ju nuk pranoni fare ndryshimin në çmimin, në rastin konkret diskutimi që kishit me zotin Kasneci. Mund të shtojmë një fjalë që të mos lejohen hapësira për abuzime, që dikush të nënkuptojë që, për sa kohë nuk kanë vendosur limit, kjo do të thotë se unë mund të ndryshoj deri në 100% çmimin. Ndërkohë, në kuptueshmërinë time dhe në argumentet tuaja sot është që nuk e lejoni fare, pra ju jeni në një nivel zero për qind të lejimit të ndryshimit të çmimit

në kontratë. Nëse ka nevojë për t'u ndryshuar, atëherë duhet të kalojmë edhe një herë në një procedurë nëse këtu mund të adaptojmë nenin përkatës për të thënë që nuk lejohet.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Në fakt, zonja Mesi, meqenëse folët edhe për kompetencat e punës sime, pra si kryetare e Komisionit të Integritimit, besoj që, e para, për sa i përket kësaj pike së cilës zoti Kasneci dhe zonja Kashta po i referohen, unë mendoj që është shumë e rëndësishme, madje duhet të jetë edhe për ju. Unë e di që ne kemi mundësinë e amendimit, por duke qenë se jemi duke folur, edhe një herë, për lekët e taksapaguesve, pra për para publike, nuk ka kohë që ta shtyjmë sa herë të duam dhe pastaj, pasi të bëhet abuzimi edhe një herë tjetër, të vazhdojmë me ndryshimet e legjislacionit, siç është bërë që në vitin 2006. Pra, ligji është ndryshuar mbi 10 herë.

Senida Mesi – Zonja kryetare, për procedurë.

Rudina Hajdari – Pastaj kjo lloj mënyre mua nuk më pëlqen.

Senida Mesi – Unë nuk iu referova fare punës sate. Por kam të drejtën time të zbatoj procedurën. Nuk kam nevojë fare të për sqarim. Të lutem!

Rudina Hajdari – Pra, për mua është shumë e rëndësishme që ta zgjidhim këtë debat, sepse zonja Kashta po e akuzon zotin Kasneci për mungesë aftësie për të lexuar...

Senida Mesi – Për procedurë.

Rudina Hajdari – Ndaj, mendoj që duke qenë...

Senida Mesi – Zonja Kashta nuk akuzoi asnjëri. Zoti Kasneci nuk akuzoi asnjëri. Secili mban qëndrimin e tij profesional, njëri me argumentet e tij dhe tjetra me argumentet e saj.

Rudina Hajdari – Jo, jo...

Senida Mesi – Ju lutem, kujdes në moderimin e këtij komisioni!

Rudina Hajdari – Zonja Kashta i tha zotit Kasneci që është lapsus.

Senida Mesi – Zonjën Kashta nuk e kam dëgjuar në asnjë moment se akuzoi njeri. Ajo dha argumentet e saj.

Rudina Hajdari – Tha që është lapsus për pikën e referencës.

Senida Mesi – Zoti Kasneci dha argumentet e tij. Zonja kryetare, po flas për procedurë.

Rudina Hajdari – Ju lutem, zonja Mesi, sepse e keni zakon që, sa herë jeni në këtë komision, ju merrni përsipër të bëheni zëdhënëse e çdokujt që ftohet këtu për të bërë atë punë që bëj edhe unë. Duhet të bënit të njëjtën punë, duhet të monitoronit pikërisht mënyrën se si është

bërë ky projektligj nga autoriteti përgjegjës. Ndaj, ju lutem, bashkohuni me mua kur flas dhe bëhet ky debat ndërmjet zotit Kasneci dhe zonjës Kashta. Dakord?

Senida Mesi – Jo, jo, një sekondë!

Zonja kryetare, ju lutem!

Rudina Hajdari – Ju lutem shumë, po ju them që të mos më ndërhyri më!

Senida Mesi – Ju lutem, se kam dy orë e gjysmë që po ju dëgjoj.

Në dy orë e gjysmë...

Rudina Hajdari – Nuk po më dëgjoni mua, në fakt...

Senida Mesi – Jo, jo, një sekondë!

Ky komision ka edhe anëtarë të tjerë dhe ti duhet t' respektosh të gjithë anëtarët e Komisionit të Integritetit Europian.

Rudina Hajdari – Ne po dëgjojmë shqyrtimin e një projektligji shumë të rëndësishëm për vendin tonë.

Senida Mesi – Shumë bukur pra. Çfarë po bëjmë? Në dy orë e gjysmë po diskutojmë në këtë komision...

Rudina Hajdari – Ndaj, nëse ju marrim dy orë kohë nga koha juaj e vyer, na vjen shumë keq, por këto, edhe një herë po ju them, janë para publike me të cilat abuzohet.

Senida Mesi – Kujdes me komentet!

Rudina Hajdari – Ne e kemi për detyrë të rrimë këtu dhe ta zgjidhim këtë debat. Dakord?

Senida Mesi – Respekto etikën e komunikimit!

Rudina Hajdari – Dakord? Unë nuk jam këtu të jem zëdhënëse e zonjës Kashta se ku e ka mbaruar shkollën dhe sa e aftë është. Nuk është detyra ime kjo. Kur ta kem unë këtë detyrë, pra që të shikoj CV-në e zonjës Kashta, dhe ndoshta ndonjë ditë mund të më duhet, nuk e di, nuk i dihet asnjëherë se si vijnë punët, do të jetë një procedurë tjetër totalisht. Sot ne jemi duke shqyrtuar projektligjin dhe mua kjo më intereson. Më vjen shumë mirë që ka një eksperiencë të gjatë.

Senida Mesi – Zonja kryetare, mbarove? Edhe mua ma ndërpretë fjalën!

Rudina Hajdari –Ndaj, do të doja që edhe zoti Kasneci, i cili ka po ashtu një eksperiencë shumë të gjatë në këtë komision, ta zgjidhnin këtë konflikt, sepse nga 10%-shi, pra këtu thuhet, se tani ne lexojmë shqip dhe...

Senida Mesi – Lexojeni pra.

Rudina Hajdari – Të lutem, zonja Mesi!

Senida Mesi – Jo, jo, dua fjalën! Të lutem, ma jep fjalën për procedurë.

Rudina Hajdari – Mos më ndërprit. Po flisnim...

Senida Mesi – Të kam dëgjuar për dy orë e gjysmë.

Rudina Hajdari – Nuk më keni dëgjuar mua. Zonja Mesi, ju kam lënë hapësirë të gjithëve.

Senida Mesi – Të kam dëgjuar ty... Tani ti do të na lexosh ne. Unë kërkoj fjalën për procedurë, është e drejta ime.

Rudina Hajdari – Jeni duke folur ndërkohë.

Keni folur tri herë për procedurë që ta dini. Nuk e di pse e keni zakon që të futeni në konflikt me mua dhe më pas ne i zgjidhim këto konflikte midis njëra-tjetrës.

Senida Mesi – Unë nuk kam asnjë konflikt me asnjë njeri. Kërkoj fjalën për procedurë...

Rudina Hajdari – Gjithmonë unë ndaj jush kam respekt, por këtu po flasim për një projektligj shumë të rëndësishëm. Edhe një herë, nuk kam folur unë për dy orë, në fakt, i kam lënë hapësirë zonjës Kashta për të folur më shumë se çdo anëtar tjetër i Komisionit të Integritetit. Për këtë pikë besoj se zonja Kashta mund të dakordësohet. Pra, nuk kam folur unë dy orë këtu.

E dyta, pa dashur të prek ndonjë tel të zonjës Mesi, ajo çka po ju them...

Senida Mesi – Si e thatë, zonja kryetare? Ma thoni edhe një herë.

Rudina Hajdari – Ndonjë tel.

Senida Mesi – Je kryetare e komisionit?

Rudina Hajdari – Po.

Senida Mesi – Je edhe deputete?

Rudina Hajdari – Po.

Senida Mesi – Dhe fyen pa teklif këdo që të del para? Kush ta lejon ty këtë gjë?!

Rudina Hajdari – Nuk është ofendim të thuash “të prek ndonjë tel”.

Senida Mesi – Ou? Me të vërtetë? Dhe këtë ta lejon edukata jote dhe detyra që të kemi caktuar si kryetare e këtij komisioni?!

E nderuar zonja kryetare, respekto procedurën, e para!

E dyta, na lejo të gjithëve të flasim kur kërkojmë fjalën.

Dhe e treta, tela apo pa tela, më vjen keq që ti abuzon me detyrën që të ka caktuar Kuvendi i Shqipërisë, me detyrën që të kanë caktuar ata taksapagues që mundohesh t’i ruash!

Unë po respektoj procedurën; po respektoj secilin prej jush; po respektoj zotin Kasneci, zonjën Kashta dhe këdo të ftuar që ne kemi në komision dhe kërkoj të respektoni procedurën.

Kujdes me artikullimin e fjalive, se nuk ta kemi borxh të dëgjojmë jo dy orë e gjysmë, por shihe regjistrimin dhe shihe sa ke folur ti, sa ka folur zoti Kasneci apo zonja Mesi, apo zoti Gjoni e të tjerë me radhë.

Tani, nëse duam të bëjmë argumente, të cilat nuk ekzistojnë, hajde ta lëmë diku tjetër dhe jo në Komisionin e Integritimit European. Këtu jemi për të përcaktuar dhe për të definuar nëse një ligj apo një nen i këtij ligji nuk duhet të jetë, ka nevojë për përmirësime ligjore apo ka nevojë për përmirësime në semantikë, hajdeni ta bëjmë.

E dyta, i takon autoritetit dhe institucionit përgjegjës që ka sjellë propozimin e ligjin për të rënë dakord ose jo nëse do ta përafrojë 100% apo jo një direktivë.

Detyra e Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit është për të na evidentuar neve nga ana teknike dhe profesionale sa është përqindja e përafrimit dhe cilat janë rekomandimet e tyre, me qëllim që të jemi më të përafuar dhe më pranë direktivave të Bashkimit European.

Në fund të ditës ne jemi anëtarë të këtij komisioni, dëgjojmë argumentet dhe kundërgargumentet, nuk po mbroj dhe nuk po i dal asnjërit zot. Kam dëgjuar argumentet dhe kam kuptueshmërinë time profesionale. Madje, të kërkoj dhe të ftoj që, nëse ka paqartësi të tilla midis dy autoriteteve, sigurisht, është vota ajo që do të përcaktojë nëse ne do t'i marrim 100% propozimet e Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit apo do të respektojmë atë për çfarë autoriteti, i cili ka sjellë në rastin konkret projektligjin, bie ose jo dakord. Nëse autoriteti nuk është gati për të avancuar me një hapje apo lehtësim të një procedure, unë jam dakord, sepse ai e di nëse është ose jo i gatshëm të monitorojë një sistem më të hapur.

Në momentin që autoritetet përkatëse, në rastin konkret APP-ja, na thotë dhe deklaron: “Unë nuk jam e gatshme në këtë moment të shkoj nga 20% në 50%, apo nga 10% unë e dua zero”, unë e respektoj këtë vendimmarrje, sepse ato i dinë për momentin burimet njerëzore dhe sistemet për të monitoruar hapjen ose jo.

Për hir të procedurës, në respekt edhe të punës reciproke të njëri-tjetrit, unë kërkova që të kalojmë në të njëjtën procedurë. Nëse ka një koleg deputet që ende është i paqartë në lidhje me se si është shprehur neni përkatës, të takon ty t'i ftosh për të bërë komente apo pyetje, me qëllim që të gjithë deputetët e pranishëm në këtë komision të jenë të qartë për çfarë po votojnë pro ose kundër një amendimi ose një projektligji. Është shumë e thjeshtë.

Të lutem, tërhiq fjalën e prekjës në tela apo të mosprekjës në tela.

Rudina Hajdari – Dakord.

Zonja Mesi, ai çfarë thashë unë nuk besoj se ishte ofendim. Unë thjesht po mundohem të jem sa më elegante...

Senida Mesi – Është ofendim për mua dhe më ofendove.

Rudina Hajdari – Më fal, se kjo lloj praktike nuk aplikohet në asnjë komision se si në mënyrë sa më qytetare po mundohem ta drejtoj këtë lloj komisioni. Gjithsesi, ju keni të drejtën tuaj të bëni qortimet tuaja dhe për këtë ne mund të flasim me njëra-tjetrën, nuk ka absolutisht asnjëlloj problemi për mua.

Meqenëse zonja Mesi tha, nëse deputetët kanë ose jo qartësi në lidhje me këtë projektligj, po ju them që unë jam e paqartë dhe, duke qenë se jam edhe deputete, dua që ta zgjidh këtë paqartësi, sepse është e rëndësishme. Pika 20, në gjykimin tim, është e rëndësishme, prandaj e kisha të nevojshme ta dëgjoja zonjën Kashta, sepse ajo tha se është lapsus. Shikoja, po ashtu, edhe zotën (*nuk kuptohet.*) që lëvizte kokën duke e miratuar dhe duke e konfirmuar faktin që ishte lapsus, ndërkohë që zoti Kasneci, nga ana tjetër, vazhdon t'i qëndrojë mendimit të tij.

Për këtë unë nuk isha e sigurt, sepse nuk më vjen mirë kur thuhet se është një lapsus dhe zoti Kasneci nuk e gjen dot atë lapsus, ndërkohë që, çfarë shikoj unë këtu, është që ju në kuadrin ligjor (edhe një herë, jemi te pika 2 e nenit 127) e keni bërë 20%, ndërkohë që direktiva e thotë 10% ose 15%. Ndaj është shumë më e madhe hapësira për ta amenduar më vonë. Ky është abuzimi që mund t'i bëhet kontratës nesër, pasnesër. Si nuk ju vjen keq për këtë?

Domethënë, si ligjvënës, të gjithë ne bashkë, edhe me zonjën Mesi duhet të na shqetësojë, se kjo gjë dhe është gjë thelbësore e këtij projektligji nëse ne sjellim një projektligj risi dhe pretendojmë që të mos krijohen më këto raporte siç i kemi.

Direktiva e thotë në mënyrë të hapur që këtu ka një lloj tavani. Jam dakord, unë e di se si janë direktivat, të cilat nuk kanë nevojë të huazohen apo të bëhen njësoj si në projektligje, por duhen adoptuar dhe duhen zbatuar me vullnetin e mirë. Pra, ato direktiva duhen të plotësohen ose të zbatohen 100%, por ne do t'i bëjmë sipas mundësive që kemi, pa asnjë lloj justifikimi, por në këtë pikë mendoj që nuk vlen kjo lloj logjike, sepse mendoj se direktiva e thotë dhe ka një arsye pse e thotë, se pse duhet të jetë ky lloj tavani. Tavani është që, nëse 20% ajo e ka 10% dhe nëse ne japim 20% të vlerës së kontratës të fillimit, që ne ta ndryshojmë, atëherë është shumë më e madhe sesa e ka direktiva vetë, 20%-shi nga 10%-shi, është shumë më shumë. Unë dua të di vetëm logjikën tuaj, zonja Kashta, në lidhje me këtë pikë. Pra, është lapsus apo është diçka që ju e keni

ngritur, sepse e mendoni që në kontekstin shqiptar duhet të jetë në këtë lloj mënyre, duhet t'i japim më shumë mundësi amendimit të kontratës pas miratimit?

Reida Kashta – Faleminderit, zonja kryetare!

Më vjen keq për debatin, sepse me zotin Kasneci jemi kolegë shumë të mirë. Ajo që ne thamë, kur iu referuam lapsusit, u referohemi tabelave të përputhshmërisë, jo nenit, jo tekstit. Në tabelën e përputhshmërisë është thënë që neni 127 për afron pikën 72/2 të nenit të direktivës, në fakt duhet të ishte 72/1 e nenit të direktivës. Pra, i referohemi tabelës së përputhshmërisë. Ajo që ne themi tani dhe përsëri ngelet në vendimmarrjen tuaj, është që, me këtë nen kemi synuar të për afrojmë vetëm neni 72/1 të direktivës.

Nëse më lejohej të lexoj në anglisht pjesën përkatëse të nenin të direktivës, thuhet: *“However, any increase in price shall not exceed 50 % of the value of the original contract”*. Pra, i referohet, zoti Kasneci, vlerës së kontratës bazë: *“However, any increase in price shall not exceed 50 % of the value of the original contract. Where several successive modifications are made...”* dhe vazhdon logjikën, siç e kemi. Këtë paragraf kemi përkthyer në pikën 2 të nenin 127. Pra, ngritja e çmimit nuk duhet të tejkalojë, pra shtesa e kontratës të amendohet më shumë se 50% e vlerës fillestare. Këtë synim kemi pasur në të për afrojmë, mbase nuk jemi të qartë, mbase nuk ka dalë ashtu siç duhet, por mua më lind përgjegjësia minimalisht, që të sqaroj këtë qëllim tonë. Qëllimi ynë është për afrojmë pikën 1 të nenin 72. Pika 1 e nenit 72 jep kushtet kur mund të bëhet një amendim kontrate sipas ligjit dhe thotë në fund që ky amendim, edhe nëse plotëson kushtet, nuk mund të bëhet asnjëherë nëse vlera e këtij amendimi do të shkonte mbi 50% të kontratës.

Ajo që ne kemi dashur të themi, që s'është e qartë, është që: *“Po, amendimi i kontratës si koncept lejohej nga legjislacioni shqiptar, do të bëhet vetëm nëse plotësojmë kushtet, por vlera nuk mund të tejkalojë 20%”*. Pra, atë 50%-shin e kemi përkthyer në 20%. Pika 2, që flet për rritje 15% dhe 10%, u referohet amendimeve pa kushtet fare dhe këtë gjë ne nuk kemi traspozuar, sepse nuk mendojmë që duhet të lejojmë amendime kontratash pa asnjë lloj kushti. Pra, kemi traspozuar vetëm pikën 1, vetëm nëse plotësojmë kushtet dhe jo 50%, sa e ka direktiva, por 20%. Nëse vlerësojmë që duhet, ky është vlerësimi përfundimtar i Agjencisë së Prokurimit Publik. Unë e kam nenin këtu përpara, nuk e di sa është e mundur që të keni një nen direktive përpara, është neni 72, pika 2 (i) e germës “b”, e lexova dhe flet për *increasment* të 50 % të *value of the original contract*.

Faleminderit!

Ralf Gjoni – Kryetare, për procedurë?

Rudina Hajdari – Po. Fjala për ju.

Ralf Gjoni – Faleminderit, kryetare!

Së pari, ju lutem, zonja Kashta, zoti Kasneci, kjo është një bisedë që nuk na takon neve këtu në komision dhe unë do të kisha preferuar si anëtar i komisionit që ju ta kishit dakordësuar dhe zgjidhni çdo marrëveshje apo këndvështrim të ndryshëm që mund të keni për çështjen në fjalë. Mua më tingëllon më tepër që ju të dy jeni në të njëjtën linjë, por thjesht nga këndvështrime të ndryshme, të cilat me pak mprehje dhe me pak bisedim tet-a-tet mund ta zgjidhni dhe të na e sillni neve në komision në një formë pak më të pranueshme për ne.

Zonja kryetare, më bëri përshtypje ajo që tha zonja Mesi. Zonja Mesi ka të drejtë kur thotë që mund ta hedhim në votim, kjo është vërtetë që ne mund ta hedhim në votim, por nga ana tjetër, ajo ka të drejtë edhe kur thotë që s'jemi të detyruar të përafrojmë 100% legjislacionin, por me këtë mendësi, i bie që, meqë nuk qenkemi të detyruar, hajde të mos përafrojmë asnjë gjë dhe me këtë rast të mos ta kalojmë fare në Komisionin e Integritimit. Kështu që, për sa kohë që këtu bëhet fjalë për një mprehje ose debat teknik mes dy aktorëve, të cilët janë në një linjë, në botëkuptimin tim, unë mendoj që ne kemi mundësi ta përafrojmë maksimalisht legjislacionin me direktivat e BE-së.

Tani, me këtë në mendim, unë sugjeroj që nëse ka dakordësi edhe me anëtarët e tjerë të nderuar të komisionit, zonja Kashta dhe zoti Kasneci le të ritakohen së bashku dhe të dakordësojnë një formë më të pranueshme për komisionin, nuk ka nevojë ta hedhim sot për votim. Le të mblidhemi, unë jam i gatshëm të mblidhemi në çdo moment, edhe në 00:00 të natës kur vjen fjala për integrimin, le ta rimbledhim komisionin në një moment të mëvonshëm, sot, nesër, pasnesër, me qëllim që të votojmë një version më të dakordësuar mes shërbimeve të Kuvendit dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Rudina Hajdari – Zoti Gjoni, faleminderit për sugjerimin tuaj!

Mendoj se është një sugjerim i drejtë. Po dëgjojmë edhe zotin Kasneci, dhe pastaj marrim një vendim bashkërisht dhe e hedhim në votim.

Zoti Kasneci.

Dedë Kasneci – Zonja kryetare, atëherë thjesht për të mos e përsëritur edhe një herë. 50 %-shi është vetëm për çmimet, ndërsa 10%-15%-shi janë vlerat totale të kontratës në situata totalisht të ndryshme. Atëherë, nëse është ashtu siç thotë zonja Kashta, i bie të jetë kufizimi 10% dhe 15% i vlerës totale të kontratës, nuk është asgjëkundi në ligj dhe kur nuk ka kufizim autoritetet kontraktore mund të shkojnë nga 0 deri në 100%. Pra, direktiva ka dy shifra, e ka 50% për çmimet,

e ka 20, 10 dhe 15% vlerën totale të kontratës. Tani, ligji që është sjellë ka një 20%-ësh, tani ky 20%-shi , ku ta marrim se është, se nuk po kuptohet gjë?

Pika 1 e nenit 72 thotë: *“Any increase in price is not higher than 50% of the value of the original”*. *“Any increase in price”*, pra rritje në çmim, kurse 10 dhe 15%, pika tjetër është: *“10 % of the initial contract value for service and supply contracts and 15 % of the initial contract values”*. Pra, janë situata të tjera dhe 10% , 15% është për të gjithë vlerën...

Rudina Hajdari – Zoti Kasneci, ju lutem!

Dedë Kasneci – Se duhet të jemi të qartë me ato që themi.

Rudina Hajdari – Ju kuptoj qartë, se kemi goxha kohë që e konsiderojmë këtë si debat. Duke qenë se ky projektligj nuk kalon të enjten në seancë, edhe duke qenë se është një çështje e rëndësishme, është një çështje thelbësore për projektligjin, nuk është thjesht një çështje përkthimi apo togfjalësh, që nuk po merremi vesh, pra, është një gjë e rëndësishme dhe në mënyrën sesi aplikohen apo zbatohen nesër kontrata dhe është një pikë, ku shpesh herë raportet i referohen, në mënyrën sesi zbatohet kontrata, ndoshta duhet t’ju japim kohë, që të ta na e sqarojnë këtë pikë. Ky është mendimi im edhe zoti Gjoni e sugjeroi, kështu që, unë mendoj ta hedhim në votim dhe pastaj shikojmë sesi do procedojmë, por dua t’u kujtoj deputetëve që ky projektligj nuk do jetë përfshirë në seancën e ditës së enjte, prandaj kemi kohë për t’u rimbledhur edhe enjë herë, vetëm thjesht për ta votuar, pasi ta kenë ezuruar këtë debat zoti Kasneci me zonjën Kashta.

Jeni dakord ta hedhim këtë në votim, shtyrjen e votim për këtë projektligj?

Kush është pro? Dakord.

Reida Kashta – Jam pro shtyrjes.

Senida Mesi – Zonja kryetare, për procedurë, dua një koment të zonjës Kashta. Dua një prononcim të zonjës Kashta, në lidhje me shtyrjen. Zonja Kashta, ju lutem, a ka kuptueshmëri? E kuptoni ku është problemi dhe merak, nëse mund ta quaj kështu, i zotit Kasneci? Nëse po, e shtyjmë mbledhjen që këto dy palë të merren vesh. Reida, të lutem, ma sqaro pak.

Reida Kashta – Mundem?

Rudina Hajdari – Po, zonja Kashta, patjetër që ju mundeni t’i përgjigjeni zonjës Mesi.

Reida Kashta – Nuk shoh asnjë problem, që unë të diskutoj me zotin Kasneci, që të sqarohemi, sepse jemi duke folur për të njëjtë gjë dhe ndoshta nuk po kuptohemi nga mënyra sesi shprehet. Pra, jam e hapur, se unë jam e qartë në qëllimin që kemi, nëse ka një problem në mënyrën e të shprehurit apo të kuptuarit, jam përsëri e hapur ta sqarojmë dhe ta rregullojmë.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Dakord. Nëse është thjesht për t'u sqaruar, nuk besoj se përben ndonjë problem, ndaj duke qenë se ky projektligj nuk ka për të qenë në seancën e të enjtes, mendoj që mund ta shtyjme. Pasi ju të keni folur me njëri- tjetrin edhe një herë në lidhje me pikën 20, ne mund të rimblidhemi dhe të vendosim. Pastaj, është në dorë e gjithsecilit deputet të votojë, ashtu siç ka dëshirë.

Dakord.

Do ju njoftomë në vijim me mbledhjen e radhës së komisionit, por vetëm për këtë projektligj.

A jeni dakord me shtyrjen ? Shumica dakord, e shtyjme. Faleminderit shumë!

Dua të falënderoj zonjën Kashta, që qëndroi dhe dha mendimin e saj në lidhje me këtë projektligj dhe të gjithë përfaqësuesit e tjerë meqë erdhën dhe u bënë pjesë e kësaj mbledhjeje!

Falënderoj edhe deputetët!

Edhe një herë, kërkoj ndjesë, nëse zonja Mesi është ende në linjë, kërkoj ndjesë, nëse ka pasur ndonjë keqkuptim në lidhje me debatin që patëm këtu më parë.

Ju uroj të gjithëve një ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA